



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 20 korrik 2012
Nr. Ref.:AGJ 284/12

AKTGJYKIM

në

Rastet K.O. 29/12 dhe K.O. 48/12

**Amendamentet e propozuara kushtetuese, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit
të Republikës së Kosovës më 23 mars 2012 dhe 4 maj 2012**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Ivan Čukalović, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Duke u mbështetur në nenin 144.1 të Kushtetutës, 31 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës propozuan një sërë amendamentesh kushtetuese. Më 23 mars 2012, sipas kompetencave të veta të përcaktuara në nenin 144.3 të Kushtetutës, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kryetari i Kuvendit) dorëzoi një grup të amendamenteve të propozuara për të vlerësuar paraprakisht nëse ato pakësojnë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.
2. Kryetari i Kuvendit e dorëzoi edhe një grup tjetër të amendamenteve në Gjykatë më 4 maj 2012. Ky grup i dytë i amendamenteve dallonte në disa aspekte nga grupi i parë i amendamenteve.
3. Kryetari i Kuvendit është parashtrues i kërkesave në Gjykatën Kushtetuese.

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.9 dhe në nenin 144.3 të Kushtetutës, në nenin 20 dhe në nenin 54 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009, (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 23 mars 2012, Kryetari i Kuvendit e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese duke kërkuar që Gjykata të vlerësonte nëse amendamentet e propozuara nga 31 deputetë pakësojnë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës. Këto amendamente të propozuara janë të paraqitura në Aneksin A.
6. Më 26 mars 2012, Kryetari e caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Snezhana Botusharova.
7. Më 27 mars 2012, Gjykata kërkoi nga parashtruesi të dorëzonte informata dhe dokumente mbështetëse lidhur me procedurën e ndërmarrë në përputhje me nenin 144 të Kushtetutës.
8. Më 29 mars 2012, kërkesa iu komunikua Shkëlqesisë së saj, znj. Atifete Jahjaga, Presidente e Republikës së Kosovës dhe z. Sami Kurteshi, Avokat i Popullit,.
9. Më 30 mars 2012, Gjykata mori informatat shtesë dhe dokumentet mbështetëse që i kishte kërkuar nga parashtruesi.
10. Më 24 prill 2012, Avokati i Popullit iu përgjigj Gjykatës dhe ofroi vërejtjet e veta për amendamentet e propozuara. Përgjigja e Avokatit të Popullit është e paraqitur më poshtë.
11. Presidentja e Republikës i dorëzoi vërejtjet e veta në lidhje me amendamentet e propozuara më 3 maj 2012, të paraqitura më poshtë.
12. Kryetari i Kuvendit e dorëzoi edhe një grup tjetër të amendamenteve të propozuara të Kushtetutës në Gjykatë më 4 maj 2012. Ky grup i dytë i amendamenteve dallon në disa aspekte nga grupi i amendamenteve të dorëzuara më 23 mars 2012. Grupi i dytë

i amendamenteve u mbështet nga gjysma e deputetëve që i bashkëngjitën emrat e tyre në amendamentet e para, kurse gjysma tjetër e deputetëve janë deputetë të tjerë. Grupi i dytë i amendamenteve u regjistrua nën numrin K.O. 48-12. Këto amendamente të propozuara janë të paraqitura në Aneksin B.

13. Më 7 maj 2012, Kryetari i Gjykatës kërkoi nga Kryetari i Kuvendit të tregonte cili grup i amendamenteve duhet të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese.
14. Kryetari i Kuvendit u përgjigj më 10 maj 2012 duke thënë se grupi i dytë i amendamenteve duhet të shqyrtohet nga Gjykata.
15. Më 10 maj 2012, Gjykata vendosi t'i bashkojë këto dy kërkesa për shkak të lidhjes me njëra-tjetrën sa i përket objektit të çështjes dhe personave që i parashtrojnë kërkesat.
16. I njëjti Gjyqtar raportues dhe Kolegj shqyrtues u caktuan edhe për grupin e dytë të amendamenteve.
17. Me anë të shkresës së 22 qershorit 2012, Avokati i Popullit ofroi komentet e veta lidhur me grupin e dytë të amendamenteve të propozuara.

Përmbledhje e fakteve

18. Kuvendi i Republikës së Kosovës e miratoi tekstin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe ajo hyri në fuqi më 15 qershor 2008. Në Kapitullin XIII [Dispozitat Përfundimtare], neni 144 [Amendamenti] i Kushtetutës e autorizon Qeverinë, Presidentin apo një të katërtën (1/4) e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, siç përcaktohet në Rregulloren e punës së Kuvendit, të propozojnë ndryshime dhe amendamente të kësaj Kushtetute.
19. Udhëheqësit e Aleancës Kosova e Re (AKR), të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), z. Behgjet Pacolli, z. Isa Mustafa dhe z. Hashim Thaçi, nënshkruan një Memorandum të Marrëveshjes më 6 prill 2011.
20. Sipas kësaj Marrëveshjeje, Shkëlqesia e saj, znj. Atifete Jahjaga, u nominua si kandidate për Presidente të Republikës së Kosovës dhe palët përkatëse ofruan mbështetjen e tyre të plotë për kandidaturën e saj.
21. Në Marrëveshje më tej thuhet që udhëheqësit pajtohen që menjëherë ta formojnë një "Komision për Reformën e Zgjedhjeve Presidenciale" që do t'i hartojë amendamentet kushtetuese dhe legjislacionin e ndërlidhur, të nevojshëm për të siguruar që Presidenti i Kosovës zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga populli, dhe që zgjedhjet e drejtpërdrejta presidenciale në Kosovë do të mbahen jo më vonë se gjashtë muaj nga data në të cilën këto ndryshime dhe amendamente të nevojshme të Kushtetutës dhe legjislacioni hyjnë në fuqi.
22. Sipas Marrëveshjes, udhëheqësit më tej pajtohen që Ligji i reformuar për zgjedhjet e përgjithshme do të përfshijë një dispozitë që thotë se zgjedhjet e para të përgjithshme sipas ligjit të amendamentuar do të mbahen jo më vonë se 18 muaj nga data në të cilën ligji i reformuar dhe amendamentimet e ndërlidhura kushtetuese hyjnë në fuqi.

23. Në Marrëveshje në fund thuhet që udhëheqësit do t'i paraqesin ndryshimet e përmendura në Marrëveshje në mbledhjen e Kuvendit në të cilën zgjidhet Presidenti i Kosovës.
24. Më 7 prill 2011, Kuvendi me 75 vota për, 2 abstenime dhe asnjë votë kundër, e miratoi Rezolutën Nr. 04-R-2, me të cilën e mbështeti Memorandumin e Marrëveshjes së sipërpërmendur.
25. Të njëjtën ditë, Kuvendi me 80 vota për, 10 të pavlefshme dhe 10 për kandidaten tjetër, e miratoi Vendimin Nr. 04-V-11, me të cilin Shkëlqesia e saj, znj. Atifete Jahjaga, u zgjodh Presidente e Republikës së Kosovës dhe se mandati i Presidentit është pesë (5) vjet.
26. Më 15 prill 2011, shefat e grupeve parlamentare: PDK, LDK, AAK, SLS, AKR dhe 6+, dorëzuan një propozim në Kuvend për formimin e dy komisioneve: një Komision për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe një Komision për amendamentimin e ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës.
27. Më 22 prill 2011, Kuvendi me 76 vota për, 4 abstenime dhe 6 vota kundër, e miratoi Vendimin Nr. 04-V-12, për formimin e Komisionit për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Komisioni).
28. Më 6 maj 2011, Kryetari i Kuvendit e njoftoi Komisionin në hollësi lidhur me statusin dhe kompetencat e Komisionit.
29. Më 23 dhjetor 2011, Komisioni kërkoi zgjatjen e mandatit të vet.
30. Më 20 janar 2012, Kuvendi me 62 vota për, 1 abstenim dhe 2 vota kundër, e miratoi Vendimin Nr. 04-V-227, me të cilin u miratua kërkesa për zgjatjen e mandatit të Komisionit edhe për dy muaj.
31. Më 20 mars 2012, kryesuesi i Komisionit ia dorëzoi Kuvendit amendamentimet e propozuara të Kushtetutës, të shoqëruar me listën e nënshkrimeve të 31 deputetëve të Kuvendit.
32. Më 23 mars 2012, Kryetari i Kuvendit ia dërgoi amendamentimet e propozuara Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar që Gjykata të vlerësojë nëse amendamentet e propozuara pakësojnë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.
33. Shkresa e sipërpërmendur përmbante shtojcën e 19 marsit 2012, nga kryesuesi i Komisionit për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, drejtuar Kryetarit të Kuvendit, në të cilën thuhet "Në përputhje me nenin 144 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, po ua dërgoj pakon e amendamenteve kushtetuese për procedim të mëtutjeshëm".

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

34. Gjykata tani do të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë, të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
35. Gjykata duhet së pari duhet të përcaktojë nëse parashtruesi mund të konsiderohet palë e autorizuar sipas nenit 113.9 të Kushtetutës, i cili përcakton: "*Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet të referojë amendamentet kushtetuese të propozuara*

para miratimit në Kuvend, me qëllim që të konstatohet nëse amendamenti i propozuar i zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me kapitullin II të Kushtetutës”.

36. Kryetari i Kuvendit, dr. Jakup Krasniqi, e dorëzoi kërkesën në këtë Gjykatë për vlerësim paraprak të amendamenteve të propozuara të Kushtetutës. Prandaj, sipas nenit 113.9 të Kushtetutës, parashtruesi është palë e autorizuar, dhe ka të drejtë ta parashtojë këtë rast në Gjykatë.
37. Prandaj, Gjykata konkludon që parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri dhe kërkesa është e pranueshme.

Përgjigja e Avokatit të Popullit

38. Sa i përket amendamentit 1, nenit 84.10 të Kushtetutës, Avokati i Popullit ka kërkuar që fjala “bashkëpunim” të përcaktohet në mënyrë më të qartë për t’i evituar dallimet e mundshme të interpretimit.
39. Sa i përket amendamentit 1, nenit 84.21 të Kushtetutës, Avokati i Popullit ka kërkuar që shprehja “së bashku” të përcaktohet në mënyrë më të qartë.
40. Sa i përket amendamentit 1, nenit 84.22 të Kushtetutës, Avokati i Popullit konsideron që Kryeministri duhet të jetë më i përfshirë në vendimin për të shpallur gjendje të jashtëzakonshme.
41. Sa i përket amendamentit 1, nenit 84.30 të Kushtetutës, Avokati i Popullit mendon që Presidenti nuk mund të jetë përgjegjës për raportin për gjendjen në Republikën e Kosovës.
42. Sa i përket amendamentit 1, nenit 84.31 të Kushtetutës, Avokati i Popullit konsideron që Avokati i Popullit duhet të emërohet nga Kuvendi.
43. Sa i përket amendamentit 3, nenit 86.1 të Kushtetutës, Avokati i Popullit konsideron që fjalia “*ashtu siç përcaktohet me ligj*” duhet të shtohet në fund të paragrafit.
44. Sa i përket amendamentit 4, nenit 87.2 të Kushtetutës, Avokati i Popullit konsideron që Presidenti duhet të betohet para Kuvendit.
45. Sa i përket amendamentit 7, nenit 90 të Kushtetutës, Avokati i Popullit konsideron që pjesa më e madhe e nenit të propozuar duhet të përfshihet në Ligjin për Presidentin. Avokati i Popullit gjithashtu është i mendimit që kompetencat si faljet individuale apo emërimi i gjyqtarëve duhet të vazhdojnë të ushtrohen nga Ushtruesi i Detyrës së Presidentit. Ai thekoi se mungesa dhe/ose pamundësia e Presidentit nuk duhet të ndikojë në mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, nëse kjo zgjat shumë kohë.
46. Sa i përket amendamentit 8, nenit 91.1 të Kushtetutës, Avokati i Popullit konsideron që dorëheqja duhet t’i dorëzohet Kryetarit të Kuvendit, i cili me automatizëm do të fillojë ta ushtrojë detyrën e Presidentit.
47. Sa i përket amendamentit 8, nenit 91.6 të Kushtetutës, Avokati i Popullit konsideron që në rast të pamundësisë së Kryetarit të Kuvendit për ta ushtruar detyrën, ajo i kalon nënkryetarit më të vjetër, e kështu me radhë.
48. Me anë të shkresës së 22 qershorit 2012, Avokati i Popullit i ofroi komentet e veta lidhur me grupin e dytë të amendamenteve të propozuara, duke theksuar që neni

84.31 duhet të fshihet dhe që neni 134.1 duhet të mbetet me shtesën: “Me të drejtën e rizgjedhjes së Ombudspersonit”.

Përgjigja e Presidentes së Republikës

49. Presidentja e Republikës u përgjigj më 3 maj 2012, por vetëm në lidhje me amendamentin 10, lidhur me shpalljen e zgjedhjeve të para presidenciale, i cili e zëvendëson nenin ekzistues 162 të Kushtetutës.
50. Presidentja konsideron që amendamenti i propozuar parasheh shkarkimin, përkatësisht ndërprerjen e mandatit kushtetues të Presidentit. Presidentja pohon që kjo bëhet përmes një veprimi retroaktiv të amendamentit të propozuar kushtetues dhe pa dyshim do të shpjerë në “shkarkim”, edhe pse kjo fjalë nuk është përdorur.
51. Shkarkimi, sipas propozimit, do ta ndërpresë mandatin e Presidentit në një mënyrë që nuk është paraparë me nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës duke shkelur kështu të drejtën për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur. E drejta për t’u zgjedhur gjithashtu parashikon kohëzgjatjen e mandatit. Rrjedhimisht, ky element i të drejtës për t’u zgjedhur nuk mund të ndryshohet sapo një individ të jetë zgjedhur në funksion publik. Kushtetuta nuk parasheh asnjë rezervim apo kufizim të këtij elementi të së drejtës, pasi të jetë zgjedhur.
52. Presidentja theksoi se neni 91 [Shkarkimi i Presidentit] i Kushtetutës parashikon raste specifike kur Presidenti mund të shkarkohet nga posti, duke treguar kështu që Presidenti nuk mund të shkarkohet nëpërmjet një amendamenti kushtetues.
53. Presidentja pohon që amendamenti i propozuar është në kundërshtim me parimin e përgjithshëm të drejtësisë për moszbatimin e dispozitave kushtetuese dhe ligjore, apo ndryshimeve të tyre, në mënyrë retroaktive.
54. Amendamenti i propozuar shkel parimin e mosdiskriminimit, siç parashihet në nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës.
55. Presidentja gjithashtu thotë që amendamenti i propozuar shkel parimin e ndarjes së pushteteve.

Kushtetutshmëria e amendamenteve të propozuara

Shtrirja e juridiksionit kushtetues

56. Siç u tha më lart në pjesën Procedura në Gjykatë, grupi i dytë i amendamenteve të propozuara u dorëzua në Gjykatë nga Kryetari i Kuvendit. Ky grup i dytë i amendamenteve dallon në disa aspekte nga grupi i parë i amendamenteve të dorëzuara.
57. Gjykata rikujton që Kryetari i Kuvendit e njoftoi Gjykatën se vetëm grupi i dytë i amendamenteve duhet të shqyrtohet.
58. Gjykata është e vetëdijshme për nevojën e sigurisë juridike në lidhje me këtë çështje. Prandaj, Gjykata konsideron që grupi i dytë i amendamenteve e ka përfshirë dhe zëvendësuar grupin e parë të amendamenteve të propozuara dhe vlerësimi që përfshihet në këtë Aktgjykim ka të bëjë vetëm grupin e dytë të amendamenteve.
59. Prandaj, Gjykata do ta bëjë atë vlerësim duke u bazuar në kompetencën e vet juridiksionale sipas nenit 113.9 të Kushtetutës, që do të thotë konfirmimin se

amendamentet e propozuara nuk i pakësojnë të drejtat dhe liritë e garantuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

60. Gjykata gjithashtu thekson që në përputhje me nenin 112 [Parimet e Përgjithshme] të Kapitullit VIII [Gjykata Kushtetuese] të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.
61. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron që, sa i përket vlerësimit të kushtetutshmërisë së cilitdo amendament të propozuar të Kushtetutës, sipas nenit 144.3, amendamenti i tillë duhet të konsiderohet në dritën e Kapitullit II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] të Kushtetutës, i cili sipas nenit të vet 21 [Parimet e Përgjithshme], përbëhet nga të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të cilat janë baza e rendit juridik të Republikës së Kosovës.
62. Përveç kësaj, Gjykata konsideron që Kapitulli III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] dhe të drejta të tjera mund të jenë të zbatueshme në këtë proces, pasi të drejtat specifike të përcaktuara janë zgjerim i të drejtave dhe lirive të njeriut të përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës, në veçanti, i atyre të drejtave të përcaktuara në nenin 24 [Barazia para Ligjit].
63. Kjo është veçanërisht kështu edhe nga pikëpamja e dispozitave të nenit 21.2 të Kushtetutës, i cili përcakton që Republika e Kosovës do t'i mbrojë dhe garantojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, siç parashihet me Kushtetutë, jo doemos ato të përfshira vetëm në Kapitullin II.
64. Prandaj, me rastin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së amendamenteve të propozuara, kjo Gjykatë nuk do t'i marrë parasysh vetëm të drejtat dhe liritë e njeriut të përfshira në Kapitullin II, por edhe të gjitha të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me Kushtetutë dhe të parashikuara me shkronjën dhe frymën e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës.
65. Është me rëndësi të theksohet që Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe të përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën. Ky është një juridiksion *ex-post* i Gjykatës si garantues i Kushtetutës për ta siguruar përputhjen e legjislacionit me aktin më të lartë të shtetit, pra me Kushtetutën.
66. Përveç këtij juridiksioni, Gjykata gjithashtu ka juridiksionin e ashtuquajtur *ex-ante* për vlerësim paraprak të kushtetutshmërisë së amendamentit të propozuar. Ky juridiksion i jepet Gjykatës, si mbrojtëse e Kushtetutës, për të siguruar që amendamenti i propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.
67. Gjykata konsideron që Kushtetuta është e qartë në atë drejtim. Amendamentet kushtetuese mund të miratohen nga Kuvendi vetëm pasi Kryetari i Kuvendit të Kosovës ta ketë parashtruar amendamentin e propozuar në Gjykatë Kushtetuese për konfirmim paraprak që amendamenti i propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.
68. Gjykata gjithashtu konsideron që neni 21 i Kushtetutës duhet të lexohet në lidhje me nenin 7.1 të Kushtetutës, i cili i përcakton vlerat e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës që bazohet "*në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.*"

69. Sipas nenit 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme] të Kushtetutës, shmangia nga të drejtat dhe liritë themelore që mbrohen me Kushtetutë mund të bëhet vetëm pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, sipas kësaj Kushtetute dhe vetëm deri në masën sa është e domosdoshme nën rrethanat e dhëna. Përveç kësaj, shmangia nga të drejtat dhe liritë themelore që garantohen me nenet 23, 24, 25, 27, 28, 29, 31, 33, 34, 37 dhe 38 të kësaj Kushtetutës nuk do të lejohet në asnjë rrethanë.
70. Prandaj, është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të sigurojë mbrojtjen e këtyre vlerave themelore të rendit kushtetues. Në këtë drejtim, vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës, siç përcaktohet në paragrafin 1 të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, i cili përcakton:
- “Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës.”*
71. Neni 116 i Kushtetutës zbatohet për të gjitha vendimet e Gjykatës, duke përfshirë Aktgjykimin e saj për kushtetutshmërinë e amendamenteve të propozuara.
72. Gjykata tani do ta shqyrtojë me radhë secilin prej amendamenteve të propozuara të grupit të dytë, të paraqitura në Aneksin B.

I. Amendamenti 1 i propozuar: Neni 84 [Kompetencat e Presidentit]

73. Amendamenti 1 propozon të ndryshohen paragrafët 1, 9, 10, 20, 21, 22, 23, 24, 26 dhe 30 të nenit 84, dhe t'i shtohen dy paragrafë të ri 31 dhe 32.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 84.1 të Kushtetutës

74. Sipas nenit aktual 84.1, Presidenti i Republikës së Kosovës:

“përfaqëson Republikën e Kosovës brenda dhe jashtë;”

75. Sipas amendamentit të propozuar, neni 84.1 thotë me sa vijon:

“[Presidenti i Republikës së Kosovës] përfaqëson Republikën e Kosovës;”

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 84.1 të Kushtetutës

76. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar nuk e ndryshon substancën e nenit 84.1. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 84.1 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 84.9 të Kushtetutës

77. Sipas nenit aktual 84.9, [Presidenti i Republikës së Kosovës]:

“mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese;”

78. Sipas amendamentit të propozuar, neni 84.9 thotë me sa vijon:

“[Presidenti i Republikës së Kosovës] ngre çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me këtë Kushtetutë”.

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 84.9 të Kushtetutës

79. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar nuk e ndryshon substancën e nenit 84.9. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 84.9 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 84.10 të Kushtetutës

80. Sipas nenit aktual 84.10, [Presidenti i Republikës së Kosovës]:

“udhëheq politikën e jashtme të vendit;”

81. Sipas amendamentit të propozuar, neni 84.10 thotë me sa vijon:

“bashkëpunon me Qeverinë në lidhje me politikën e jashtme të vendit;”

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 84.10 të Kushtetutës

82. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar nuk e ndryshon substancën e nenit 84.10. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 84.10 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 84.20 të Kushtetutës

83. Sipas nenit aktual 84.20, [Presidenti i Republikës së Kosovës]:

“emëron Komandantin e Forcave të Sigurisë të Kosovës, pas rekomandimit të Kryeministrit;”

84. Sipas amendamentit të propozuar, neni 84.20 thotë me sa vijon:

“emëron Komandantin e Forcave të Sigurisë të Kosovës, pas rekomandimit të Kryeministrit;”

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 84.20 të Kushtetutës

85. Gjykata konsideron që kompetenca e rekomandimit në lidhje me emërimin e Komandantit të Forcave të Sigurisë të Kosovës është bartur prej Qeverisë tek Kryeministri. Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 84.20 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 84.21 të Kushtetutës

86. Sipas nenit aktual 84.21, [Presidenti i Republikës së Kosovës]:

“së bashku me Kryeministrin, emëron Drejtorin, Zëvendësdrejtorin dhe Inspektorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Intelegjencë;”

87. Sipas amendamentit të propozuar, neni 84.21 thotë me sa vijon:

“emëron Drejtorin e Agjencisë së Kosovës për Intelejencë;”

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 84.21 të Kushtetutës

88. Gjykata vëren që Presidenti do ta emërojë Drejtorin e Agjencisë së Kosovës për Intelejencë pa Kryeministrin. Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 84.21 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 84.22 të Kushtetutës

89. Sipas nenit aktual 84.22, [Presidenti i Republikës së Kosovës]:

“vendos për shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme, në konsultim me Kryeministrin;”

90. Sipas amendamentit të propozuar, neni 84.22 thotë me sa vijon:

“shpall Gjendjen e Jashtëzakonshme, pasi ta njoftojë Kryeministrin.”

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 84.22 të Kushtetutës

91. Gjykata vëren që Presidenti mund ta shpallë gjendjen e jashtëzakonshme pa u konsultuar me Kryeministrin. Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 84.22 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 84.23 të Kushtetutës

92. Sipas nenit aktual 84.23, [Presidenti i Republikës së Kosovës]:

“mund të kërkojë mbledhje të Këshillit të Sigurisë të Kosovës dhe i kryeson ato në kohën e Gjendjes së Jashtëzakonshme;”

93. Sipas amendamentit të propozuar, neni 84.23 thotë me sa vijon:

“kryeson Këshillin e Sigurisë të Kosovës;”

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 84.23 të Kushtetutës

94. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar nuk e ndryshon substancën e nenit 84.23. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 84.23 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 84.24 të Kushtetutës

95. Sipas nenit aktual 84.24, [Presidenti i Republikës së Kosovës]:

“vendos për formimin e misioneve diplomatike e konsullare të Republikës së Kosovës, në bazë të konsultimit me Kryeministrin;”

96. Sipas amendamentit të propozuar, neni 84.24 thotë me sa vijon:

“themelon misionet diplomatike e konsullore të Republikës së Kosovës, me propozim të Qeverisë;”

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 84.24 të Kushtetutës

97. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar nuk e ndryshon substancën e nenit 84.24. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 84.24 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 84.26 të Kushtetutës

98. Sipas nenit aktual 84.26, [Presidenti i Republikës së Kosovës]:

“emëron Kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;”

99. Sipas amendamentit të propozuar, neni 84.26 thotë me sa vijon:

“emëron Kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në pajtim me këtë Kushtetutë;”

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 84.26 të Kushtetutës

100. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar nuk e ndryshon substancën e nenit 84.26. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 84.26 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 84.30 të Kushtetutës

101. Sipas nenit aktual 84.30, [Presidenti i Republikës së Kosovës]:

“së paku një herë në vit i drejtohet Kuvendit të Kosovës përkitazi me fushëveprimtarinë e tij/saj;”

102. Sipas amendamentit të propozuar, neni 84.30 thotë me sa vijon:

“së paku një herë në vit i drejtohet Kuvendit të Kosovës përkitazi me gjendjen në Republikën e Kosovës;”

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 84.30 të Kushtetutës

103. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar nuk e ndryshon substancën e nenit 84.30. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 84.30 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket nenit shtesë të propozuar 84.31 të Kushtetutës

104. Sipas amendamentit të propozuar, neni i ri 84.31 thotë me sa vijon:

“emëron Ombudspersonin, me propozim të Kuvendit;”

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 84.31 të Kushtetutës

105. Në përgjigjet e veta në këto kërkesa, Avokati i Popullit theksoi se Ombudspersoni duhet të emërohet nga Kuvendi për shkak të marrëdhënies së ngushtë ndërmjet Ombudspersonit dhe Kuvendit. Ai theksoi që ai institucion ka fuqi rekomanduese dhe Kuvendi mund t’u përgjigjet rekomandimeve të tij me iniciativa legjislative dhe/ose interpelanca për agjencitë ekzekutive që i shkelin të drejtat e njeriut.

106. Gjykata vëren që propozimi është që Avokati i Popullit, një post kushtetues, roli i të cilit përcaktohet në nenet 132 deri në 135 të Kushtetutës, të emërohet nga Presidenti me propozim të Kuvendit. Në Kushtetutë nuk janë të përcaktuara rrethanat në të cilat Presidenti mund ta refuzojë emërimin e Avokatit të Popullit të propozuar nga Kuvendi. Ndonëse kjo çështje nuk del drejtpërdrejt në kontekst të kërkesës në fjalë, ka të ngjarë që nëse Presidenti refuzon ta bëjë një emërim të tillë, ai është objekt i shqyrtimit përveç nëse Presidenti ofron baza të arsyeshme.

107. Duke pasur parasysh këtë që u tha më lart, Gjykata konsideron që neni i ri i propozuar 84.31 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket nenit shtesë të propozuar 84.32 të Kushtetutës

108. Sipas amendamentit të propozuar, neni i ri 84.32 thotë me sa vijon:

“kryen edhe detyra të tjera, të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj.”

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 84.32 të Kushtetutës

109. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar nuk e ndryshon substancën e nenit 84, përveç që i jep kompetenca shtesë, siç parashihet me Kushtetutë dhe ligj. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e nenit të ri të propozuar 84.32. Prandaj, Gjykata konkludon që neni i ri i propozuar 84.32 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

II. Amendamenti 2 i propozuar: neni 85 [Kualifikimet për Zgjedhjen e Presidentit]

110. Amendamenti 2 propozon që neni 85 të fshihet dhe të zëvendësohet me një nen të ri 85.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 85 të Kushtetutës

111. Neni aktual 85 thotë me sa vijon:

“President i Republikës së Kosovës mund të zgjedhet çdo shtetas i Republikës së Kosovës, i cili e ka mbushur moshën tridhjetë e pesë (35) vjeçare”.

112. Sipas amendamentit të propozuar, neni 85 thotë me sa vijon:

“1. President i Republikës së Kosovës mund të jetë secili shtetas i Republikës së Kosovës, i cili në momentin e kandidimit e ka mbushur moshën 35 (tridhjetë e pesë) vjeçare.

2. Për t’u kualifikuar si kandidat për President, secili shtetas i Republikës së Kosovës duhet të ketë qenë banor i përhershëm i Republikës së Kosovës gjatë pesë viteve të fundit para kandidimit për President.

3. Para dhënies së betimit si President i Republikës së Kosovës, kandidati i zgjedhur President duhet të japë dorëheqje nga çdo post publik.

4. Përveç kushteve të përcaktuara në këtë nen, kandidatët për President duhet të përmbushin edhe kushtet e tjera të përcaktuara me ligj.”

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 85.1 të Kushtetutës

113. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar nuk e ndryshon substancën e nenit 85 lidhur me kriterin e moshës për të pasur të drejtë për t’u kandiduar për postin e Presidentit të Republikës. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që neni i ri i propozuar 85.1 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 85.2 të Kushtetutës

114. Propozimi për ta kufizuar të drejtën e kandidatëve për President, të cilët gjatë pesë vjetëve të fundit para kandidimit për President kanë qenë banorë të përhershëm në Republikën e Kosovës, shkakton ca vështirësi. Në shikim të parë, mund të duket e arsyeshme të kufizohet mbajtësi i postit me këtë kriter të banimit për të siguruar që Presidenti është i lidhur ngushtë me popullin dhe shtetin para se të hyjë në postin më të lartë politik në vend.

115. Megjithatë, neni 45.1 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] i Kushtetutës përcakton që:

“Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.”

116. E drejta për të marrë pjesë në procesin zgjedhor është e drejtë e pandarë e njeriut në një shoqëri demokratike. Kjo Gjykatë e ka theksuar rëndësinë e kësaj të drejte, jo vetëm për të zgjedhur, pra të votojë në zgjedhje të rregullta të lira e të drejta, por edhe të drejtën për t’u zgjedhur (shih Aktvendimin për Papranueshmëri në Rastin Nr. KI 73/09, Mimoza Kusari-Lila kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të 23 marsit 2010). Gjykata e theksoi rëndësinë e zgjedhjeve në paragrafin 24 të atij Aktvendimi me sa vijon:

“[Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut] GJEDNJ ka shprehur vazhdimisht rëndësinë e zgjedhjeve të lira dhe të demokracisë në Aktgjykimet e saj. Në të njëjtin Aktgjykim, Gjykata shprehu mendimin e saj për si vijon: ‘Demokracia paraqitet si modeli i vetëm politik i parashikuar nga Konventa dhe, për pasojë, i vetmi që pajtohet me të’. GJEDNJ, në të njëjtin Aktgjykim citoi me miratim Kodin e Praktikës së Mirë, i aprovuar nga Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) në seancat e 51 (Udhëzimet) dhe 52 (Raporti) me 5-6

korrik dhe 18-19 tetor 2002 (Opinioni nr. 190/2002, CDL-AD(2002) 23 rev). Komisioni i Venecias me këtë rast deklaroi:

Pesë parimet mbi të cilat mbështetet trashëgimia zgjedhore e Evropës janë se zgjedhjet duhet të jenë: universale, të barabarta, të lira, të fshehta dhe përmes një votimi të drejtpërdrejt. Përveç kësaj, zgjedhjet duhet të mbahen ne intervale të rregullta.”

117. Përveç kësaj, Kushtetuta e Kosovës bazohet në parimin e barazisë së qytetarëve të vet në ushtrimin e të drejtave të tyre. Kjo shihet qartë nga neni 24 [Barazia para Ligjit], i cili parasheh që çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore pa diskriminim dhe se askush nuk mund të diskriminohet në asnjë bazë, duke përfshirë “statusin personal”. Neni i propozuar ua ndalon personave që nuk kanë qenë banorë të shtetit të Kosovës të jenë kandidatë për postin e Presidentit të Republikës së Kosovës.
118. Neni 155 [Shtetësia] i Kushtetutës parashikon që të gjithë banorët e ligjshëm të Kosovës në datën e miratimit të kësaj Kushtetute, 15 qershor 2008, dhe të gjithë personat që kanë banuar në Kosovë më 1 janar 1998 dhe pasardhësit e tyre të drejtpërdrejtë gëzojnë të drejtën e shtetësisë së Kosovës pavarësisht nga vendbanimi i tyre i tanishëm apo shtetësia që kanë. Këto ishin kategori të gjera të personave që gëzonin dhe akoma gëzojnë të drejtën e shtetësisë.
119. Historia e kohëve të fundit e Kosovës tregon se ekziston një numër i madh i personave të tillë që ishin të pranishëm në Kosovë më 1 janar 1998. Një numër i madh i mërgatës u largua nga Kosova për arsye të ndryshme, njëra prej tyre ishte arsyeja ekonomike. Këta persona që kanë shtetësinë e Kosovës apo që kanë të drejtë ta marrin shtetësinë e Kosovës nuk mund të diskriminohen në bazë të statusit të tyre aktual personal si emigrantë për shkaqe ekonomike ose të tjera. Amendamenti i propozuar i vë këta persona në pozitë të pabarabartë përballë qytetarëve të tjerë që kanë jetuar këtu gjatë pesë vjetëve të fundit.
120. Amendamenti i propozuar paraqet kufizim të së drejtës së cilitdo qytetar të Republikës së Kosovës që nuk ka pasur banim të përhershëm në Kosovë për pesë vjet të plota para kandidimit për post. Prandaj, Gjykata konkludon që mund të ketë pakësim të së drejtës për t'u zgjedhur të atyre qytetarëve që nuk e përmbushin kriterin e banimit dhe për këtë arsye propozimi për ta ndryshuar Kushtetutën me shtimin e këtij neni të ri 85.2 pakëson të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 85.3 të Kushtetutës

121. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar është në përputhje me nenin ekzistues 88 të Kushtetutës që Presidenti nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër publik apo ndonjë funksion tjetër në parti politike. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që neni i ri i propozuar 85.3 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 85.4 të Kushtetutës

122. Neni i ri i propozuar thotë me sa vijon:

“4. Përveç kushteve të përcaktuara në këtë nen, kandidatët për President duhet të përmbushin edhe kushtet e tjera të përcaktuara me ligj.”

123. Gjykata vëren që dispozita e cila kërkon që kandidatët për President t'i përmbushin kushtet e tjera të përcaktuara me Ligj nuk mund të veprojë si mekanizëm për t'i modifikuar kriteret për qasje në postin e Presidentit të Republikës apo për ushtrimin e postit të Presidentit të Republikës, përveç nëse kufizimet e tilla janë të parapara me Kushtetutë
124. Gjykata konsideron që kjo dispozitë nuk mund të përdoret për nxjerrjen e një ligji që do t'i ndryshonte kriteret për qasje në postin e Presidentit të Republikës apo për ushtrimin e postit të Presidentit të Republikës në një mënyrë që është në kundërshtim me Kushtetutën. Modifikimet e tilla mund të bëhen vetëm me amendament kushtetues. Prandaj, Gjykata përcakton që nëse propozohet një ndryshim kushtetues, Gjykata duhet të konfirmojë nëse modifikimi i tillë i propozuar pakëson apo nuk pakëson të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

III. Amendamenti 3 i propozuar: neni 86 [Zgjedhja e Presidentit]

125. Amendamenti 3 propozon që neni 86 të fshihet dhe të zëvendësohet me një nen të ri 86.
126. Neni aktual 86 thotë me sa vijon:

- “1. Presidenti i Republikës së Kosovës zgjedhet nga Kuvendi, me votim të fshehtë.*
- 2. Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës duhet të bëhet jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit të Presidentit aktual.*
- 3. Secili shtetas i Republikës së Kosovës mund të nominohet si kandidatë për President të Republikës së Kosovës, nëse ajo/ai siguron nënshkrimet e të paktën tridhjetë (30) deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Deputetët e Kuvendit mund të nënshkruajnë vetëm për një kandidatë për President të Republikës së Kosovës.*
- 4. Zgjedhja e Presidentit bëhet me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.*
- 5. Nëse asnjëri kandidat nuk merr shumicën prej dy të tretave (2/3) në dy votimet e para, organizohet votimi i tretë në mes të dy kandidatëve të cilët kanë marrë numrin më të lartë të votave në votimin e dytë dhe kandidati që merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve, zgjedhet President i Republikës së Kosovës.*
- 6. Nëse në votimin e tretë, asnjëri kandidat nuk zgjidhet President i Republikës së Kosovës, shpërndahet Kuvendi dhe shpallen zgjedhjet e reja, të cilat duhet të mbahen brenda dyzet e pesë (45) ditësh.”*

127. Sipas amendamentit të propozuar, neni 86 thotë me sa vijon:

- “1. Presidenti i Republikës së Kosovës zgjedhet drejtpërdrejt nga qytetarët me të drejtë vote.*
- 2. Zgjedhjet Presidenciale shpallen nga Kryetari i Kuvendit, jo më vonë se gjashtë muaj para përfundimit të mandatit të rregullt të Presidentit të Republikës së Kosovës.*

3. Secili shtetas i Republikës së Kosovës, që i plotëson kushtet e përcaktuara në këtë Kushtetutë, mund të kandidohet për President: (a) nga subjektet politike parlamentare, që, në pajtim me ligjin, kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet e fundit; (b) nga subjektet politike që mbajnë ulëse të garantuara në Kuvend dhe (c) përmes petitionit të dorëzuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, me nënshkrimet e së paku 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) votuesve të kualifikuar në Republikën e Kosovës. Një subjekt politik parlamentar mund të kandidojë vetëm një kandidat. Procesi i kandidimit bëhet sipas afateve kohore dhe procedurave të përcaktuara me ligj.

4. Nëse kandidati për President merr shumicën absolute (më shumë se 50%) të votave të vlefshme në rrethin e parë, atëherë zgjedhet President i Republikës së Kosovës. Nëse asnjë kandidat nuk merr shumicën absolute të votave në rrethin e parë, mbahet rrethi i dytë i zgjedhjeve në mes të dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave në rrethin e parë. Rrethi i dytë i zgjedhjeve mbahet jo më vonë se 30 ditë nga rrethi i parë. Kandidati, i cili merr shumicën e votave në rrethin e dytë të zgjedhjeve, zgjedhet President i Republikës së Kosovës.”

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 86.1 të Kushtetutës

128. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar i Kushtetutës i cili parasheh zgjedhjen e Presidentit të Republikës nga qytetarët me të drejtë vote është përmirësim i të drejtës së qytetarëve. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që neni i ri i propozuar 86.1 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 86.2 të Kushtetutës

129. Gjykata konsideron që dispozita për shpalljen e zgjedhjeve për President të ri të Republikës gjashtë muaj para përfundimit të mandatit të rregullt të Presidentit nuk ndikon në të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të parashikuara me Kushtetutë. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që neni i ri i propozuar 86.2 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 86.3 të Kushtetutës

130. Paragrafi i ri në nenin 86.3 propozon kriteret për nominimin e kandidatëve për postin e Presidentit të Republikës kur Presidenti zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët. Aktualisht, pasi vetëm deputetët e Kuvendit mund ta zgjedhin Presidentin, kriteri për nominim është që ai/ajo mund të paraqesë nënshkrimet e së paku 30 deputetëve. Pasi secili deputet mund ta nominojë vetëm një kandidat, kjo do të thotë që më së shumti katër kandidatë mund të konkurrojnë sipas sistemit të tanishëm. Teorikisht, nuk ka arsye pse nuk mund të ketë numër më të madh të kandidatëve kur sistemi ndryshon në zgjedhje të drejtpërdrejtë nga qytetarët.

131. Tani propozohet që subjektet politike parlamentare të cilat e kanë kaluar pragun zgjedhor, sipas ligjit, mund të propozojnë kandidatë për postin e Presidentit, dhe subjektet politike që mbajnë ulëse të garantuara në Kuvend dhe, së paku 15.000 votues me të drejtë vote, përmes petitionit të dorëzuar me nënshkrime të veta. Afatet kohore dhe procedurat e tjera duhet të përcaktohen me ligj.

132. Duket të ketë arsyetim për të drejtën e subjekteve politike që mbajnë ulëse të garantuara në Kuvend për të pasur të drejtë për të propozuar kandidatë, posaçërisht duke pasur parasysh vlerat e diversitetit shumetnik dhe vlerat e tjera të mbrojtura me Kushtetutë, siç përcaktohet në nenin 3 [Barazia para Ligjit].
133. Ngjashëm, propozimi me peticion publik i numrit të propozuar prej 15.000 votuesve me të drejtë vote e përmbush kriterin që është i pranishëm në shumë shtete demokratike. Megjithatë, ky propozim ua mohon të drejtat subjekteve politike që nuk e kanë kaluar pragun zgjedhor për ta propozuar kandidatin e tyre për postin e Presidentit.
134. Prandaj, një parti politike që është e regjistruar në mënyrë legjitime dhe ka të drejtë të marrë pjesë në zgjedhje si çdo parti tjetër politike, i mohohet e drejta për ta paraqitur kandidatin e zgjedhjes së tyre.
135. Gjykata konsideron që kufizimi i tillë i diskriminon subjektet e ligjshme të cilat pritet të kenë të drejtë të marrin pjesë në jetën publike. Kjo ua mohon anëtarëve dhe mbështetësve të subjekteve të tilla politike të drejtën për ta paraqitur kandidatin e tyre të propozuar për postin e Presidentit. Një ndalesë e tillë nuk e përmbush kriterin e proporcionalitetit, që pritet të përmbushet, për përjashtimin e tyre nga ky aspekt i pjesëmarrjes në jetën politike të shtetit.
136. Në të vërtetë, neni 24 i Kushtetutës ndalon diskriminimin e personave në shumë baza. Njëra prej tyre është "*mendimeve politike ose të tjera*". Personat që dëshirojnë ta shprehin mendimin e vet politik kanë të drejtë të plotë ta bëjnë atë si anëtar i një partie politike të themeluar ligjërisht. Partitë politike kanë status special të mbrojtur me ligj. Partitë mund të formohen sipas kriterëve të përcaktuara me ligje dhe, kur të themelohen, duhet të trajtohen në mënyrë jodiskriminuese.
137. Gjykata konsideron që mund të ketë diskriminim të pajustificuar ndaj partive politike nëse ato nuk kanë të drejtë të propozojnë kandidatë për postin e Presidentit.
138. Prandaj, Gjykata konkludon që neni i ri i propozuar 86.3, pasi nuk lejon propozimin nga të gjitha subjektet politike të regjistruara, pakëson të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.
139. Gjykata vëren që propozimi për President të Republikës mund të sigurohet vetëm me përfshirjen e partive politike ose me peticion dhe mbështetje të 15.000 qytetarëve. Askush nuk mund të parashikojë sa kandidatë mund të propozohen me peticion të qytetarëve. Kjo u mundëson partive politike të kenë rol të madh lidhur me atë se kush mund të propozohet për postin e Presidentit.
140. Gjykata më tej vëren që neni 88 [Papajtueshmëria] i Kushtetutës, sa i përket formës aktuale dhe asaj që propozohet në amendament i nenit 88, ndalon ushtrimin e çdo funksioni në parti politike. Baraspesha që duhet të arrihet nga cilido President i ardhshëm në detyrë që ushtron postin e Presidentit dhe kërkon mbështetjen e partive politike duhet të kihet parasysh nëse ai President në detyrë dëshiron të rizgjidhet. Vështirësia e gjetjes së rrugës e cila siguron që neni 88 nuk cenohet, në ndërkohë që ka edhe angazhim në procesin politik të Presidentit në detyrë, kërkon shqyrtim dhe trajtim të kujdesshëm.

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 86.4 të Kushtetutës

141. Gjykata konsideron që dispozita për mbajtjen e rrethit të dytë të votimit nëse asnjë kandidat nuk merr shumicën absolute të votave në rrethin e parë nuk ndikon në të

drejtat dhe liritë themelore të njeriut të parashikuara me Kushtetutë. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që neni i ri i propozuar 86.4 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

IV. Amendamenti 4 i propozuar: neni 87 [Mandati dhe Betimi]

142. Amendamenti 4 propozon që neni 87 të fshihet dhe të zëvendësohet me një nen të ri 87.

143. Neni aktual 87 thotë me sa vijon:

“1. Presidenti i Republikës së Kosovës fillon mandatin pasi të ketë dhënë betimin para Kuvendit të Kosovës. Teksti i betimit rregullohet me ligjin.

2. Mandati i Presidentit është pesë (5) vjet.

3. Pas përfundimit të mandatit të parë, Presidenti mund të rizgjedhet vetëm edhe një herë.”

144. Sipas amendamentit të propozuar, neni 87 thotë me sa vijon:

“1. Mandati i Presidentit të Republikës së Kosovës është pesë (5) vjet dhe fillon pasi që kandidati i zgjedhur të ketë dhënë betimin.

2. Presidenti betohet para Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese në një vend publik të përcaktuar me ligj. Teksti i betimit është:

“Betohem se me tërë qenien time do të ruaj dhe mbroj pavarësinë, sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës së Kosovës, garantimin e të drejtave dhe lirive për të gjithë qytetarët, respektimin dhe mbrojtjen e Kushtetutës dhe ligjeve, ruajtjen e paqes dhe mirëqenies së të gjithë qytetarëve, do të jem lojal vetëm ndaj Republikës së Kosovës, duke heqë dorë nga të gjitha obligimet ndaj ndonjë shteti tjetër që janë në kundërshtim me përgjegjësitë e miya në Republikën e Kosovës, dhe të përfaqësoj me tërë fuqinë time unitetin e qytetarëve të Republikës së Kosovës.”

3. Presidenti mund të rizgjedhet vetëm për një mandat tjetër.

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 87 të Kushtetutës

145. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar nuk e ndryshon substancën e nenit 87, përveç që parashikon futjen e tekstit të betimit në Kushtetutë. Asgjë në tekstin e betimit nuk ngrit çështje që mund të konsiderohen se ndikojnë në të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të parapara me Kapitullin II. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 87 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

V. Amendamenti 5 i propozuar: neni 88 [Papajtueshmëria]

146. Amendamenti 5 propozon që neni 88 të fshihet dhe të zëvendësohet me një nen të ri 88.

147. Neni aktual 88 thotë me sa vijon:

“1. Presidenti nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër publik.

2. Pas zgjedhjes, Presidenti nuk mund të ushtrojë asnjë funksion në parti politike.”

148. Sipas amendamentit të propozuar, neni 88 thotë me sa vijon:

“1. Presidenti nuk mund të mbajë as të ushtrojë ndonjë funksion tjetër publik.

2. Presidenti nuk mund të mbajë as të ushtrojë ndonjë funksion në një subjekt politik dhe as të jetë anëtar i ndonjë subjekti politik.”

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 88 të Kushtetutës

149. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar nuk e ndryshon substancën e nenit 88. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 88 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

VI. Amendamenti 6 i propozuar: neni 89 [Imuniteti]

150. Amendamenti 6 propozon që neni 89 të fshihet dhe të zëvendësohet me një nen të ri 89.

151. Neni aktual 89 thotë me sa vijon:

“Presidenti i Republikës së Kosovës gëzon imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi për veprimet dhe vendimet brenda fushëveprimit të përgjegjësive të Presidentit të Republikës së Kosovës.”

152. Sipas amendamentit të propozuar, neni 89 thotë me sa vijon:

“Presidenti i Republikës së Kosovës gëzon imunitet nga ndjekja penale dhe paditë civile për veprimet dhe vendimet që janë brenda kompetencave të tij.”

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 89 të Kushtetutës

153. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar nuk e ndryshon substancën e nenit 89. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 89 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

VII. Amendamenti 7 i propozuar: neni 90 [Mungesa e Përkohshme e Presidentit]

154. Amendamenti 7 propozon që neni 90 të fshihet dhe të zëvendësohet me një nen të ri 90.

155. Neni aktual 90 thotë me sa vijon:

“1. Në rast se Presidenti i Republikës së Kosovës përkohësisht nuk është i aftë për të përmbushur përgjegjësitë e tij/saj, ajo/ai mund t’ia kalojë vullnetarisht detyrat e postit të tij/saj, Kryetarit të Kuvendit, i cili do të jetë Ushtrues i Detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës. Urdhri i Presidentit për kalimin e përgjegjësive duhet të përmbajë veçanërisht arsyet dhe kohëzgjatjen e kalimit të përgjegjësive, nëse ka njohuri për to. Presidenti i Republikës së Kosovës do të rifillojë ushtrimin e përgjegjësive kur të jetë në gjendje t’i ushtrojë përgjegjësitë, dhe kështu Kryetarit të Kuvendit i pushon posti i Ushtruesit të Detyrës së Presidentit.

2. Në rast se nuk ka ndodhur kalimi vullnetar i përgjegjësive, Kuvendi i Republikës së Kosovës, pas konsultimit me konsiliumin mjekësor, me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve vendos nëse Presidenti i Republikës së Kosovës është përkohësisht i paaftë për të ushtruar përgjegjësitë e veta. Kryetari i Kuvendit të Kosovës do të shërbejë si Ushtrues i Detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës derisa ajo/ai të bëhet i aftë që të rifillojë ushtrimin e përgjegjësive të Presidentit.

3. Posti i Ushtruesit të Detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, nuk mund të ushtrohet për një periudhë më të gjatë se gjashtë (6) muaj.”

156. Sipas amendamentit të propozuar, neni 90 thotë me sa vijon:

“1. Nëse Presidenti i Republikës së Kosovës përkohësisht nuk është në gjendje të ushtrojë kompetencat e tij, ai mund t’ia kalojë vullnetarisht ushtrimin e kompetencave të tij Kryetarit të Kuvendit, i cili bëhet Ushtrues i Detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës. Vendimi me shkrim i Presidentit për kalimin e përgjegjësive përmban në veçanti arsyet dhe kohëzgjatjen e kalimit të përgjegjësive, nëse kohëzgjatja në fjalë mund të parashikohet. Presidenti i Republikës së Kosovës rifillon ushtrimin e kompetencave të tij kur të jetë në gjendje për të bërë këtë dhe, me këtë rast, Kryetarit të Kuvendit i përfundon posti i Ushtruesit të Detyrës së Presidentit.

2. Nëse Presidenti, për arsye shëndetësore, nuk është në gjendje të ushtrojë kompetencat e tij dhe nuk ka ndodhur kalimi vullnetar i përgjegjësive, Kuvendi i Republikës së Kosovës, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve, mund të fillojë procedurën për të vlerësuar nëse gjendja shëndetësore nuk ia lejon Presidentit ushtrimin e kompetencave të tij. Kuvendi kërkon nga institucioni kompetent shëndetësor të themelojë Konsiliumin e Mjekëve, për të vlerësuar gjendjen shëndetësore të Presidentit, dhe për të dorëzuar raportin në Kuvend. Nëse në raportin e Konsiliumit konstatohet se Presidenti nuk është i aftë për të ushtruar kompetencat e tij, Kuvendi, me 2/3 (dy të tretat) e votave të të gjithë deputetëve, mund të vendosë për zëvendësimin e përkohshëm të Presidentit. Me këtë rast, Kryetari i Kuvendit të Kosovës ushtron detyrën e Presidentit. Presidenti i Republikës së Kosovës në çdo kohë mund të kërkojë vlerësimin të ri të gjendjes shëndetësore dhe të kthehet në detyrë, nëse Konsiliumi i Mjekëve konstaton se Presidenti është i aftë që të rifillojë ushtrimin e kompetencave të tij.

3. Nëse për çfarëdo arsye tjetër, përveç asaj shëndetësore, Presidenti i Republikës së Kosovës nuk është në gjendje për të ushtruar kompetencat e tij dhe nuk ka ndodhur kalimi vullnetar i përgjegjësive, Kuvendi i Republikës së Kosovës, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve, mund të fillojë procedurën për zëvendësimin e përkohshëm të Presidentit. Nëse Kuvendi vendos me 2/3 (dy të tretat) e votave të të gjithë deputetëve se Presidenti përkohësisht nuk është në gjendje të ushtrojë kompetencat e tij, Kryetari i Kuvendit do të ushtrojë detyrën e

Presidentit, derisa Presidenti i Republikës së Kosovës të jetë i aftë të rifillojë ushtrimin e kompetencave.

4. Përveç nëse nuk përcaktohet ndryshe me këtë Kushtetutë, posti i Ushtruesit të Detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës nuk mund të ushtrohet për një periudhë më të gjatë se 6 (gjashtë) muaj.

5. Ushtruesi i Detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës ushtron të gjitha kompetencat e Presidentit me përjashtim të:

(1) propozimin e amendamenteve kushtetuese;

(2) shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, pa miratimin e Kryeministrit;

(3) emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve të Republikës së Kosovës, të kryeprokurorit dhe të prokurorëve të Republikës së Kosovës;

(4) emërimin dhe shkarkimin e shefave të misioneve diplomatike të Republikës së Kosovës;

(5) dhënien e medaljeve, mirënjohjeve dhe të çmimeve, në pajtim me ligjin; dhe

(6) shpalljen e faljeve individuale.

6. Nëse Presidenti i Republikës së Kosovës nuk është në gjendje për të ushtruar kompetencat e tij për 6 (gjashtë) muaj, Ushtruesi i Detyrës së Presidentit menjëherë shpall vakant postin e Presidentit dhe shpall zgjedhjet e parakohshme për President, të cilat mbahen jo më vonë se 3 (tre) muaj pas mbetjes së postit të Presidentit vakant. Ushtruesi i Detyrës së Presidentit vazhdon ta ushtrojë kompetencat e Presidentit, derisa Presidenti i ri të zgjedhet dhe të bëjë betimin.

7. Nëse Konsiliumi i Mjekëve konstaton se Presidenti i Republikës së Kosovës nuk do të jetë në gjendje të ushtrojë kompetencat e tij për një periudhë më të gjatë se 6 (gjashtë) muaj, Kuvendi, me votën e 2/3 e të gjithë deputeteve, e shpall vakant postin e Presidentit. Ushtruesi i Detyrës së Presidentit menjëherë shpall zgjedhjet e parakohshme për President, të cilat mbahen jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita kur Kuvendi ka shpallur vakant postin e Presidentit. Ushtruesi i Detyrës së Presidentit vazhdon të ushtrojë kompetencat e Presidentit, derisa Presidenti i ri të zgjedhet dhe të bëjë betimin.”

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 90.1, nenit 90.3 dhe nenit 90.4 të Kushtetutës

157. Gjykata konsideron që ndryshimet e parapara nga këto amendamente nuk ngrenë çështje që mund të konsiderohen se ndikojnë në të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që neni i ri i propozuar 90.1, neni 90.3 dhe neni 90.4 nuk pakësojnë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 90.5 të Kushtetutës

158. Neni ri i propozuar 90.5 kufizon mundësinë e Ushtruesit të Detyrës së Presidentit për t'i ushtruar të gjitha kompetencat dhe funksionet e Presidentit. Kjo Gjykatë, në

rastin Nr. KO 97/10, (Në çështjen e kërkesës së parashtuar nga Ushtruesi i Detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës Dr. Jakup Krasniqi, lidhur me mbajtjen e postit të Ushtruesit të Detyrës së Presidentit dhe njëkohësisht të postit të Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë Demokratike të Kosovës) të 22 dhjetorit 2010, vërejtji me sa vijon,

“Ushtruesi i Detyrës së Presidentit nuk është President i zgjedhur dhe herë pas here mund të ngrihen pyetje lidhur me kompetencat e Ushtruesit të Detyrës së Presidentit. Asnjë çështje e tillë nuk është ngritur në këtë kërkesë. Çështjet e tilla janë çështje kushtetuese dhe Gjykata do t’i shqyrtojë këto çështje kur të ballafaqohet me kërkesën e duhur, duke marrë parasysh parimin e ndarjes së pushteteve, siç përcaktohet në Nenin 4.1 të Kushtetutës...”

159. Tani ekziston një pyetje para Gjykatës lidhur me atë nëse kufizimi për t’i ushtruar disa kompetenca të Ushtruesit të Detyrës së Presidentit sipas nenit 84 të Kushtetutës mund t’i pakësojë të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës.
160. Neni i ri 90.5 në veçanti thekson që disa kompetenca të rëndësishme, siç janë përcaktuar në nenin 84, duhet të rrinë pezull derisa Presidenti nuk është në detyrë. Disa prej këtyre kufizimeve kanë të bëjnë me çështje të rëndësishme të madhe për sigurinë e shtetit në kohë të jashtëzakonshme. Të tjerat kanë të bëjnë me udhëheqjen e duhur dhe të rregullt të shtetit kur ekziston nevoja për emërimin e gjyqtarëve apo të prokurorëve.
161. Sa i përket kufizimit të mundësisë për të shpallur gjendje të jashtëzakonshme sipas nenit të propozuar 90.5 (2), qëndrimi aktual sipas nenit 84 është që Presidenti vendos të shpallë gjendje të jashtëzakonshme në konsultim me Kryeministrin dhe propozimi i ri është që kjo të ndryshohet në shpall gjendje të jashtëzakonshme pasi ta njoftojë Kryeministrin. Situata është e tillë sa që gjendja e jashtëzakonshme mund të shpallet vetëm me përfshirjen e Presidentit. Nuk ka mundësi që Kryeministri ta shpallë gjendjen e jashtëzakonshme me iniciativë të tij. Nëse paraqiten rrethana të cilat kërkojnë që shteti të sigurohet dhe Ushtruesi i Detyrës së Presidentit i ka duart e lidhura, atëherë mund të paraqitet krizë kushtetuese. Të drejtat dhe liritë e njeriut të të gjithë qytetarëve në shtet mund të jenë në rrezik në një situatë të tillë. Prandaj, Gjykata konsideron që kufizimi i mundësisë së Ushtruesit të Detyrës së Presidentit për të shpallur gjendje të jashtëzakonshme pakëson të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 90.5 (3) të Kushtetutës

162. Një çështje tjetër ka të bëjë me kufizimin e mundësisë së Ushtruesit të Detyrës së Presidentit për emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Kosovës. Tani, Presidenti i emëron dhe shkarkon gjyqtarët në përputhje me nenin 104 [Emërimi dhe Shkarkimi i Gjyqtarëve] dhe nenin 84 (16), emëron dhe shkarkon Kryeprokurorin e Shtetit sipas nenit 84 (17), dhe emëron e shkarkon prokurorët e tjerë sipas nenit 84 (18) të Kushtetutës. Këto emërimet dhe shkarkime bëhen me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Ka pak mundësi që Presidenti, sipas kriterëve aktuale të Kushtetutës, të ndalojë ose refuzojë të bëjë emërimet apo shkarkimet pasi të bëhen propozimet. Megjithatë, administrimi i mirëfilltë i drejtësisë dhe besimi në administrimin e drejtësisë janë aspekte themelore të zbatimit të të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë, në veçanti të atyre të drejtave dhe lirive të përfshira në Kapitullin II të Kushtetutës.

163. Përveç kësaj, drejtësia nuk mund të administrohet nëse gjyqtarët dhe prokurorët nuk janë në detyrë. Pengesa për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve mund të konsiderohet pengesë për administrimin e drejtësisë dhe pakësim i të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Kapitullin II. Avokati i Popullit shprehu po të njëjtën pikëpamje në përgjigjen e tij drejtuar Gjykatës, siç u cek më lart.
164. Me të vërtetë, kufizimi i kompetencave të Ushtruesit të Detyrës së Presidentit për të emëruar gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese, të cilëve potencialisht u ndalohet të emërohen sipas këtij amendamenti të propozuar, mund të shkaktojë që Gjykata, nganjëherë, të mos ketë kuorum por ta kryer punën e vet.
165. Kjo mundësi e bllokimit të një organi të rëndësishëm të shtetit ndikon shumë në zbatimin e të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë, pasi kjo do të mund të shkaktonte paralizim kushtetues që do ta pengonte Gjykatën për ta kryer punën e vet për shkak të mungesës së kompetencës së Ushtruesit të Detyrës së Presidentit për emërimin e gjyqtarëve.
166. Duke pasur parasysh që Kuvendi i Republikës së Kosovës i zgjedh gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, kjo është arsye më tepër që Ushtruesi i Detyrës së Presidentit të ketë kompetenca të tilla që janë të nevojshme për emërimin e gjyqtarëve jo vetëm në Gjykatën Kushtetuese, por edhe për emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve siç është propozuar ligjërisht nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës të themeluar për atë qëllim.
167. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 90.5 (3) pakëson të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 90.5 (5) të Kushtetutës

168. Neni i ri i propozuar 90.5 (5) gjithashtu ia ndalon Ushtruesit të Detyrës së Presidentit shpalljen e faljeve individuale. Kompetenca fillestare sipas nenit 84 (29) është për Presidentin i cili *“shpall falje individuale, në pajtim me ligjin”*. Tani propozohet që kur një person meriton të falet, në pajtim me ligjin, falja e tillë mund të mos lejohet.
169. Për shembull, falja e tillë mund të mos lejohet në një rast ekstrem të një personi që është duke vuajtur dënimin dhe i cili mund të meritojë të lirohet në pajtim me kompetencën për të shpallur falje individuale, pasi këtij personi do t'i kufizohet liria e tij/saj derisa Presidenti i ri ta fillojë mandatin. Në një rast të tillë, nuk mund të ketë mjete të tjera juridike në dispozicion për ta siguruar lirinë e tij/saj.
170. Gjykata konsideron që një rast i tillë ka mundësi të madhe të ndikojë në një të drejtë dhe liri themelore, pra në të drejtën e lirisë, siç përcaktohet, ndër të tjera në nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës dhe nenin 5 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.
171. Prandaj, Gjykata konkludon që neni i ri i propozuar 90.5 (5) pakëson të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 90.5 (1), nenit 90.5 (4) dhe nenit 90.5 (6) të Kushtetutës

172. Neni i ri i propozuar 90.5 (1), neni 90.5 (4) dhe neni 90.5 (6) kanë të bëjnë me kufizimin e kompetencave të Ushtruesit të Detyrës së Presidentit për të propozuar amendamente kushtetuese, për të emëruar dhe shkarkuar shefa të misioneve

diplomatiqe, dhe për të dhënë medalje, mirënjohje dhe çmime. Këto janë çështje që mund të shqyrtohen brenda kursit të rëndomtë të punës pa ndikuar në të drejtat dhe liritë ekzistuese të garantuara me Kushtetutë. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i ri i propozuar i nenit 90.5 (1), nenit 90.5 (4) dhe nenit 90.5 (6) nuk i pakëson të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

VIII. Amendamenti 8 i propozuar: neni 91 [Shkarkimi i Presidentit]

173. Amendamenti 8 propozon që neni 91 të fshihet dhe të zëvendësohet me një nen të ri 91.

174. Neni aktual 91 thotë me sa vijon:

“1. Presidenti i Republikës së Kosovës mund të shkarkohet nga Kuvendi nëse ai/ajo është dënuar për kryerjen e krimit të rëndë ose nëse ajo/ai nuk është i/e aftë për të ushtruar përgjegjësitë e këtij posti për shkak të sëmundjes së rëndë ose nëse Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar se ajo/ai ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës.

2. Procedura për shkarkimin e Presidentit të Republikës së Kosovës mund të iniciohet nga një e treta (1/3) e deputetëve të Kuvendit, të cilët nënshkruajnë një petition, i cili shpjegon arsyet për shkarkim. Në rast se peticioni supozon sëmundjen e rëndë, Kuvendi do të kërkojë mendimin e konsiliumit mjekësor për gjendjen shëndetësore të Presidentit. Në rast se peticioni supozon ndonjë shkelje të rëndë të Kushtetutës, peticioni duhet t'i dorëzohet menjëherë Gjykatës Kushtetuese, e cila vendosë për këtë çështje brenda shtatë (7) ditësh nga marrja e petitionit.

3. Nëse Presidenti i Republikës së Kosovës është dënuar për ndonjë krim të rëndë ose kur nëse Kuvendi, në pajtim me këtë nen, konstaton që Presidenti nuk është i aftë të ushtrojë përgjegjësitë e tij/saj për shkak të sëmundjes së rëndë ose nëse Gjykata Kushtetuese konstaton se ajo/ai ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës, Kuvendi mund të shkarkojë Presidentin me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të tij.”

175. Sipas amendamentit të propozuar, neni 91 thotë me sa vijon:

“1. Presidenti i Republikës së Kosovës jep dorëheqje përmes dorëzimit të letër dorëheqjes te Kryetari i Gjykatës Kushtetuese. Dorëheqja është e vlefshme në momentin e pranimit të letër dorëheqjes nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese dhe është e përvokueshme.

2. Presidenti i Republikës së Kosovës mund të shkarkohet nga detyra, nëse ai dënohet për kryerjen e krimit të rëndë gjatë ushtrimit të detyrës, ose nëse Gjykata Kushtetuese konstaton se ai ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës, ose nëse kryen akt të tradhtisë ndaj shtetit.

3. Procedura për shkarkimin e Presidentit të Republikës së Kosovës, për rastet e specifikuar në paragrafin 2 të këtij neni, mund të fillohet nga 1/3 (një e treta) e deputetëve të Kuvendit ose nga 30.000 (tridhjetë mijë) qytetarë me të drejtë vote. Para se të dorëzohet në Gjykatën Kushtetuese për shqyrtim, peticioni duhet të miratohet me 2/3 (dy të tretat) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.

4. Nëse Gjykata Kushtetuese, me votat e së paku 7 (shtatë) gjyqtarëve, merr vendim se Presidenti i Republikës së Kosovës është përgjegjës për cilëndo nga

arsyet e specifikuara në paragrafin 2 të këtij neni, Presidenti konsiderohet i shkarkuar nga detyra.

5. Në rast se Presidenti i Republikës së Kosovës jep dorëheqje, shkarkohet në përputhje me dispozitat e këtij neni ose vdes, Kryetari i Kuvendit të Kosovës shërben si Ushtrues i Detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, në përputhje me kufizimet e përcaktuara në nenin 90, derisa të zgjedhet dhe të bëjë betimin Presidenti i ri. Kryetari i Kuvendit menjëherë shpall zgjedhjet e parakohshme për President të Republikës së Kosovës, të cilat mbahen jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita kur posti i Presidentit ka mbetur vakant.

6. Nëse Kryetari i Kuvendit, për ndonjë nga arsyet e përcaktuara në nenin 90 dhe 91, nuk është në gjendje të shërbejë si Ushtrues i Detyrës së Presidentit, kjo detyrë kalon te Nënkryetari i Kuvendit. Çështjet e tjera rreth bartjes së përgjegjësisë së ushtrimit të detyrës së Presidentit rregullohen me ligj.”

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 91 të Kushtetutës

176. Gjykata konsideron që ndonëse ka disa ndryshime të praktikës të parapara nga amendamenti i propozuar, ai nuk e ndryshon Kushtetutën në një mënyrë që ndikon në të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 91 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

IX. Amendamenti 9 i propozuar: nenet 18, 45, 65, 80, 82, 93, 94, 104, 109, 113, 114, 127, 131, 134 dhe 139

177. Amendamenti 9 propozon të ndryshohen nenet 18, 45, 65, 80, 82, 93, 94, 104, 109, 113, 114, 127, 131, 134 dhe 139 të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 18 të Kushtetutës

178. Neni aktual 18 thotë me sa vijon:

“1. Kuvendi i Republikës së Kosovës me votat e dy të tretave (2/3) e të gjithë deputetëve ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare për këto çështje:

(1) territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake;

(2) të drejtat dhe liritë themelore;

(3) anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare;

(4) marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga ana e Republikës së Kosovës.

2. Marrëveshjet ndërkombëtare me përjashtim të atyre në pikën 1, ratifikohen pas nënshkrimit nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

3. Presidenti i Republikës së Kosovës ose Kryeministri njoftojnë Kuvendin sa herë që të nënshkruhet një marrëveshje ndërkombëtare.

4. Amendamenti ose tërheqja nga marrëveshjet ndërkombëtare do të kenë të njëjtën procedurë të vendim marrjes sikur ajo e ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare.

5. Parimet dhe procedurat për ratifikimin dhe kontestimin e marrëveshjeve ndërkombëtare rregullohen me ligj.”

179. Sipas amendamentit të propozuar, neni 18 thotë me sa vijon:

“1. Kuvendi i Republikës së Kosovës me votat e dy të tretave (2/3) e të gjithë deputetëve ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare për këto çështje:

(1) territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake;

(2) të drejtat dhe liritë themelore;

(3) anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare;

(4) marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga ana e Republikës së Kosovës, në pajtim me ligjin.

2. Marrëveshjet ndërkombëtare me përjashtim të atyre në pikën 1, konsiderohen të ratifikuara pas nënshkrimit nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me rekomandim të Qeverisë.

3. Presidenti i Republikës së Kosovës ose Qeveria njoftojnë Kuvendin sa herë që të nënshkruhet një marrëveshje ndërkombëtare.

4. Amendamenti ose tërheqja nga marrëveshjet ndërkombëtare do të kenë të njëjtën procedurë të vendimmarrjes, sikur ajo e ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare.

5. Parimet dhe procedurat për ratifikimin dhe kontestimin e marrëveshjeve ndërkombëtare rregullohen me ligj.”

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 18 të Kushtetutës

180. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar nuk e ndryshon substancën e nenit 18. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 18 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 45.1 të Kushtetutës

181. Neni aktual 45.1 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] thotë me sa vijon:

“1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.”

182. Sipas amendamentit të propozuar, neni 45.1 thotë me sa vijon:

“1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe në ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me

përrjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor ose me dispozitat e kësaj Kushtetute.”

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 45.1 të Kushtetutës

183. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar nuk e ndryshon substancën e nenit 45.1. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 45.1 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 65.7 të Kushtetutës

184. Neni aktual 65.7 thotë me sa vijon:

“Kuvendi i Republikës së Kosovës: ...

(7) zgjedh dhe mund të shkarkojë Presidentin e Republikës së Kosovës në pajtim me këtë Kushtetutë; ...”

185. Sipas amendamentit të propozuar, neni 65.7 thotë me sa vijon:

“(7) dorëzon në Gjykatën Kushtetuese petitionin për shkarkimin e Presidentit të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 91 të Kushtetutës;”

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 65.7 të Kushtetutës

186. Gjykata konsideron që ndonëse ka disa ndryshime të praktikës të parapara nga ky amendament i propozuar, në lidhje me amendamentin e propozuar të nenit 91 të Kushtetutës, ai nuk e ndryshon Kushtetutën në një mënyrë që ndikon në të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 65.7 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 80 të Kushtetutës

187. Neni aktual 80 thotë me sa vijon:

“1. Ligjet, vendimet dhe aktet tjera miratohen nga Kuvendi me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, përveç në rastet kur është ndryshe e përcaktuar me këtë Kushtetutë.

2. Ligji i miratuar nga Kuvendi nënshkruhet nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës dhe shpallet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, pasi ta ketë nënshkruar brenda tetë (8) ditësh pasi të ketë marrë ligjin.

3. Nëse Presidenti i Republikës e kthen ligjin në Kuvend, ai/ajo duhet të theksojë arsyet e kthimit të ligjit. Presidenti i Republikës së Kosovës të drejtën e kthimit të një ligji në Kuvend, mund ta ushtrojë vetëm një herë.

4. Kuvendi, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve, vendos për miratimin e ligjit të rikthyer nga Presidenti i Republikës, dhe ligji përkatës konsiderohet i shpallur.

5. Nëse Presidenti i Republikës së Kosovës, brenda tetë (8) ditësh pas marrjes së ligjit, nuk merr asnjë vendim për shpalljen ose kthimin e tij, ligji konsiderohet i shpallur, pa nënshkrimin e saj/tij dhe publikohet në Gazetën Zyrtare.

6. Ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, përveç nëse, me vetë ligj nuk përcaktohet ndryshe.”

188. Sipas amendamentit të propozuar, neni 80 do ta ketë një paragraf të ri të vendosur, i cili thotë me sa vijon:

“Kuvendi mund të mbivotojë (refuzojë) veton e Presidentit ndaj një ligji të miratuar me shumicën e votave të të gjithë deputetëve plus dhjetë për qind vota të tjera shtesë dhe ai ligj konsiderohet i shpallur. Nëse Presidenti i Republikës ushtron të drejtën e vetos ndaj Ligjit për Buxhet, Kuvendi mund të votojë që të refuzojë (mbivotojë) veton me shumicën absolute të votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit dhe Ligji konsiderohet i shpallur. Nëse Kuvendi pranon ndryshimet e propozuara nga Presidenti në ligjin ku ai/ajo ka përdorë veton, Kuvendi vendos për miratimin e atij ligji me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm e që votojnë dhe ligji përkatës konsiderohet i shpallur.”

189. Ndonëse nuk është cekur ashtu në amendamentet e propozuara që janë dorëzuar në Gjykatë, supozohet që ky amendament është zëvendësimit i nenit 80.4.

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 80.4 të Kushtetutës

190. Gjykata konsideron që ndonëse ka disa ndryshime të praktikës të parapara nga ky amendament i propozuar, ai nuk e ndryshon Kushtetutën në një mënyrë që ndikon në të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 80.4 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 82 të Kushtetutës

191. Neni aktual 82 thotë me sa vijon:

“1. Kuvendi shpërndahet në këto raste:

(1) nëse brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e caktimit të mandatarit nga Presidenti i Republikës së Kosovës, nuk mund të formohet Qeveria;

(2) nëse për shpërndarjen e Kuvendit votojnë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve, shpërndarja bëhet me dekret të Presidentit të Republikës së Kosovës;

(3) nëse brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e fillimit të procedurës së zgjedhjes, nuk zgjedhet Presidenti i Republikës së Kosovës.

2. Kuvendi mund të shpërndahet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, pas votimit të suksesshëm të mosbesimit të Qeverisë.

192. Sipas amendamentit të propozuar, neni 82 do të ndryshohet me shfuqizimin e nenit 82.1 (3) në tërësi.

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 82 të Kushtetutës

193. shpërbërjen e Kuvendit dhe shpalljen e zgjedhjeve të parapara nga ky amendament i propozuar, liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 93 (10) dhe shtimin e nenit 93 (12) dhe nenit 93 (13) të Kushtetutës

194. *“Qeveria ka këto kompetenca: ...*
(4) (10) mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese;...”
195. *(5) “...(10) ngritë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese në pajtim me Kushtetutën;...”*
196. vijon:
“(12) i propozon Presidentit themelimin e misioneve diplomatike e konsullore të Republikës së Kosovës;
(13) udhëheq politikën e jashtme të vendit.”

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 93 të Kushtetutës

197. amendamentin e propozuar të nenit 93 (10), e misioneve diplomatike dhe konsullore dhe në sqarimin e asaj se kush e udhëheq politikën e jashtme të shtetit. Kushtetutën në një mënyrë që ndikon në të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 93 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 94 (5) dhe nenit 94 (9) të Kushtetutës

198. Neni aktual 94 (5) dhe neni 94 (9) thonë me sa vijon:

“Kryeministri ka këto kompetenca: ...

... (5) kryeson Këshillin e Sigurisë të Kosovës;...

... (9) këshillohet me Presidentin për zbatimin e politikës së jashtme të vendit;...”

199. Sipas amendamentit të propozuar, neni 94 (5) thotë me sa vijon:

“... (5) është anëtar i Këshillit të Sigurisë të Kosovës;...”

200. Sipas amendamentit të propozuar, neni 94 (9) fshihet.

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 94 të Kushtetutës

201. Gjykata konsideron që ndonëse ka ndryshim në atë se kush do ta kryesojë Këshillin e Sigurisë të Kosovës dhe që Kryeministri më nuk do të konsultohet me Presidentin për zbatimin e politikës së jashtme të shtetit, këto nuk e ndryshojnë Kushtetutën në një mënyrë që ndikon në të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 94 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 104.1 të Kushtetutës

202. Neni aktual 104.1 thotë me sa vijon:

“1. Gjyqtarët i emëron, riemëron dhe shkarkon Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.”

203. Sipas amendamentit të propozuar, neni 104.1 thotë me sa vijon:

“Gjyqtarët i emëron, riemëron dhe shkarkon Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Presidenti mund të rikthejë kandidatin e propozuar për rishqyrtim në Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Këtë të drejtë mund ta ushtrojë vetëm një herë për një kandidat. Këshilli Gjyqësor i Kosovës mund të propozojë kandidatin e njëjtë nëse siguron mbështetjen e 2/3 (dy të tretat) të anëtarëve të Këshillit.”

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 104.1 të Kushtetutës

204. Me rastin e shqyrtimit të nenit 90.5 (3) më sipër, Gjykata shqyrtoi si kufizimi i kompetencës së Ushtruesit të Detyrës së Presidentit për të emëruar gjyqtarë pakëson të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II. I njëjti arsyetim vlen edhe për veton vezulluese të propozuar për Presidentin për t'i kthyer prapa emrat e gjyqtarëve të propozuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës për t'u emëruar. Ai Këshill është zyrë e pavarur e themeluar në bazë të Kushtetutës dhe sipas nenit 108 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës] është organ përgjegjës që siguron pavarësinë dhe paanësinë e sistemit gjyqësor.

205. Ai është institucion plotësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve të veta. Ka rrezik që administrimi i sigurt dhe i vazhdueshëm i drejtësisë, i garantuar me Kushtetutë, do të pengohet nëse me kohë nuk emërohet numër i mjaftueshëm i gjyqtarëve, siç parashihet me mekanizmat tashmë të themeluar me Kushtetutë. Drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar; drejtësia administrohet në gjykata dhe nëse ka vonesë në emërimin e gjyqtarëve, siç parashihet me amendamentin e propozuar, atëherë

vonesa në qasje në drejtësi pakëson të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II.

206. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, në veçanti ato në Kapitullin II, zbatohen nga gjykatat e themeluara me Kushtetutë dhe ligje. Neni 102.1 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] në mënyrë të qartë thekson se pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës ushtrohet nga gjykatat. Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike] përcakton që *“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj”*. Këtu, Kushtetuta thekson të drejtën e qytetarëve për mjete juridike me qëllim të mbrojtjes juridike të të drejtave të tyre. Nuk mund të ketë qasje në mjete juridike pa emërimin me kohë të gjyqtarëve.
207. Gjithashtu, neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] përcakton që *“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”*. Kjo është një dispozitë themelore e cila siguron që personat kanë të drejtë në qasje në gjyqtarë për zgjidhjen e rasteve të tyre.
208. Ekziston rreziku i shkeljes së këtij neni të Kushtetutës me mosemërimin me kohë të gjyqtarëve. Të dy nenet, 32 dhe 54, përsërisin parimin e ndarjes së pushteteve deri në masën që ata përsërisin se ushtrimi i kompetencave gjyqësore dhe qasja në mjete juridike janë gurë themele të njëjës prej atyre shtyllave, pra i degës së gjyqësorit të shtetit.
209. Prandaj, çdo shkelje e mundshme e qasjes në gjykata dhe, rrjedhimisht, në gjyqtarë që marrin vendime në gjykata, pakëson të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 109.7 të Kushtetutës

210. Neni aktual 109.7 thotë me sa vijon:

“7. Kryeprokurori i Shtetit emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, në bazë të propozimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Mandati i Kryeprokurorit të Shtetit është shtatëvjeçarë, pa mundësi riemërimi.”

211. Sipas amendamentit të propozuar, neni 109.7 thotë me sa vijon:

“7. Kryeprokurori i Shtetit emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, në bazë të propozimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Presidenti mund të rikthejë kandidatin e propozuar për rishqyrtim në Këshillin Prokurorial të Kosovës. Këtë të drejtë mund ta ushtrojë vetëm një herë për një kandidat. Këshilli Prokurorial i Kosovës mund të propozojë kandidatin e njëjtë nëse siguron mbështetjen e 2/3 (dy të tretave) të anëtarëve të Këshillit. Mandati i Kryeprokurorit të Shtetit është shtatë (7) vjet, pa mundësi riemërimi.”

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 109.7 të Kushtetutës

212. Gjykata konsideron që ndonëse Presidentit do t'i jepet veto pezulluese në lidhje me emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit, kjo nuk e ndryshon Kushtetutën në një mënyrë që ndikon në të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Posti i Prokurorit të Shtetit, i themeluar me nenin 109 [Prokurori i

Shtetit] është një prej posteve të themeluara me Kushtetutë që mund të ushtrohet edhe nga zëvendësit deri në emërimin e Prokurorit të ri të Shtetit. Prandaj, postit të Prokurorit të Shtetit dallon nga ajo e gjyqtarëve të cilët duhet të ulen për të dëgjuar dhe gjykuar rastet që presin të zgjidhen në gjykatë. Për këtë arsye, nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, propozuar i nenit 109 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 113.3 (5) të Kushtetutës

213.

“Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Qeveria janë të autorizuar të ngrenë çështjet në vijim:

“(5) nëse është shkelur Kushtetuta gjatë zgjedhjes së Kuvendit.”

214. Sipas amendamentit të propozuar,

“(5) nëse është shkelur Kushtetuta gjatë zgjedhjes së Presidentit dhe Kuvendit.”

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 113.3 (5) të Kushtetutës

215. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar i jep Gjykatës Kushtetuese kompetencë në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me zgjedhjen e Presidentit sipas sistemit të propozuar për zgjedhjen e tij/saj drejtpërdrejt nga populli, ndryshon Kushtetutën në një mënyrë që ndikon në të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 113.3 (6) të Kushtetutës

216.

“6. Tridhjetë (30) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, janë të autorizuar të ngrenë çështjen nëse Presidenti i Republikës së Kosovës ka kryer shkelje serioze të Kushtetutës.”

217. Sipas amendamentit të propozuar,

“6. Kuvendi i Kosovës është i autorizuar të dorëzojë peticionin, me të cilin kërkohet shkarkimi i Presidentit të Republikës së Kosovës në përputhje me nenin 91 të Kushtetutës.”

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 113.3 (6) të Kushtetutës

218. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar e ndryshon rolin e Gjykatës Kushtetuese kur ka të bëjë me shkarkimin e Presidentit, Kushtetutën në një mënyrë që ndikon në të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Për këtë arsye,

ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 113.3 (6) nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 114.2 të Kushtetutës

219. Neni aktual 114.2 thotë me sa vijon:

“2. Gjyqtarët emërohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Kuvendit, për një mandat nëntëvjeçar, pa mundësi vazhdimi.”

220. Sipas amendamentit të propozuar, neni 114.2 thotë me sa vijon:

“2. Gjyqtarët emërohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Kuvendit, për një mandat nëntëvjeçar pa mundësi vazhdimi. Presidenti mund të kthejë kandidatin e propozuar nga Kuvendi. Këtë të drejtë mund ta ushtrojë vetëm një herë për një kandidat. Kuvendi mund të propozojë kandidatin e njëjtë, vetëm nëse siguron mbështetjen e 2/3 (dy të tretave) të votave të të gjithë deputetëve.”

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 114.2 të Kushtetutës

221. Më herët, në një pjesë të këtij Aktgjykimi, Gjykata e shqyrtoi çështjen e mungesës së kompetencës së Ushtruesit të Detyrës së Presidentit për të emëruar gjyqtarë dhe gjithashtu e shqyrtoi veton pezulluese të propozuar të Presidentit për t’ia kthyer prapa Këshillit Gjyqësor të Kosovës emërimet e gjyqtarëve.
222. I njëjti arsyetim në lidhje me rrezikun për administrimin e drejtësisë për shkak të mosemërimit me kohë të gjyqtarëve të gjykatave të rregullta vlen edhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Të gjitha arsyetimet që u përdorën për të ardhur në konkluzione zbatohen *mutatis mutandis* edhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.
223. Përveç kësaj, sipas nenit 112 [Parimet e Përgjithshme], Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën. Kushtetuta përcakton që ajo duhet të jetë plotësisht e pavarur në ushtrimin e përgjegjësive të veta.
224. Tani, Kuvendi është organi përgjegjës për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Përveç dy gjyqtarëve, vendet e të cilëve janë të rezervuara apo të garantuara pasi i përfaqësojnë bashkësitë joshumicë në Kosovë, shumica e dy të tretave të deputetëve duhet të votojnë për emërimin e tyre.
225. Qëndrimi në lidhje me emërimin e gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese është qëndrim që mund të shkaktojë vonesa të paarsyeshme nga Presidenti nëse ai/ajo e kthen prapa gjyqtarin e propozuar të Gjykatës Kushtetuese.
226. Kuorumin e Gjykatës, siç është përcaktuar me nenin 17 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, e përbëjnë shtatë gjyqtarë. Rreziku që Gjykata të mos jetë në gjendje ta zhvillojë punën e vet dhe t’i zgjidhë kërkesat për shkak të mungesës së kuorunit, qoftë edhe për një kohë të shkurtër, ndërhyr në të drejtat e parashtruesve në zgjidhjen e ankesave të tyre kushtetuese.

227. Ky është pakësim i të drejtave dhe lirive të garantuara me Kapitullin II. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 114.2 pakëson të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 127.2 të Kushtetutës

228. Neni aktual 127.2 thotë me sa vijon:

“2. Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës kryesohet nga Kryeministri me mbështetje nga Qeveria, përveç gjatë periudhës së Gjendjes së Jashtëzakonshme, sikurse është parashikuar me këtë Kushtetutë.”

229. Sipas amendamentit të propozuar, neni 127.2 thotë me sa vijon:

“2. Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës kryesohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me mbështetje nga Qeveria.”

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 127.2 të Kushtetutës

230. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar e ndryshon rolin e kryesuesit të Këshillit të Sigurisë, por kjo nuk e ndryshon Kushtetutën në një mënyrë që ndikon në të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 127 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 129.3 të Kushtetutës

231. Neni aktual 129.3 thotë me sa vijon:

“3. Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Kryeministri, pas konsultimit me Qeverinë, së bashku emërojnë Drejtorin, Zëvendësdrejtorin dhe Inspektorin e përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë. Kualifikimi dhe mandati rregullohen me ligj.”

232. Sipas amendamentit të propozuar, neni 129.3 thotë me sa vijon:

“3. Presidenti i Republikës së Kosovës emëron Drejtorin e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë. Zëvendësdrejtori dhe Inspektori i Përgjithshëm i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë emërohen nga Kryeministri. Kualifikimi dhe mandati rregullohen me ligj.”

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 129.3 të Kushtetutës

233. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar është shtuar për ta bërë atë në përputhje me amendamentin e propozuar të nenit 84.21, të shqyrtuar më sipër, prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 129.3 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 131.8 të Kushtetutës

234. Neni aktual 131.8 thotë me sa vijon:

“8. Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës, vetëm gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, ushtron funksione ekzekutive që kufizohen në funksionet që ndërlidhen në veçanti me Gjendjen e Jashtëzakonshme. Gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës do të drejtohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, sikur rregullohet me ligj. Gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës do të bashkëpunojë ngushtësisht me Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet ndërkombëtare.”

235. Sipas amendamentit të propozuar, neni 131.8 thotë me sa vijon:

“8. Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës, vetëm gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, ushtron funksione ekzekutive që kufizohen në funksionet që ndërlidhen në veçanti me Gjendjen e Jashtëzakonshme. Gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës do të bashkëpunojë ngushtë me Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet ndërkombëtare.”

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 131.8 të Kushtetutës

236. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar e ndryshon kryesinë e Këshillit të Sigurisë gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, por nuk e ndryshon Kushtetutën në një mënyrë që ndikon në të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 131 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 134.1 dhe nenit 134.5 të Kushtetutës

237. Neni aktual 134.1 thotë me sa vijon:

“1. Avokatin e Popullit e zgjedh Kuvendi i Kosovës, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të tij, për një mandat pesë (5) vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje.”

238. Neni aktual 134.5 thotë me sa vijon:

“5. Avokati i Popullit mund të shkarkohet vetëm me kërkesën e më shumë se një të tretës (1/3) së të gjithë deputetëve, dhe në këtë rast Kuvendi vendos me shumicën e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të tij.”

239. Sipas amendamentit të propozuar, neni 134.1 thotë me sa vijon:

“1. Avokati i Popullit emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti, me propozim të Kuvendit për një mandat pesë (5) vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje. Presidenti mund të kthejë kandidatin e propozuar nga Kuvendi. Këtë të drejtë mund ta ushtrrojë vetëm një herë për një kandidat. Kuvendi mund të propozojë kandidatin e njëjtë, vetëm nëse siguron mbështetjen e 2/3 (dy të tretave) të votave të të gjithë deputetëve.”

240. Sipas amendamentit të propozuar, neni 134.5 fshihet.

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 134.1 dhe nenit 134.5 të Kushtetutës

241. Gjykata konsideron që ndonëse Presidentit do t'i jepet veto pezulluese në lidhje me emërimin e Avokatit të Popullit dhe duhet të ketë ndryshime sa i përket mënyrës së shkarkimit të Avokatit të Popullit, këto nuk e ndryshojnë Kushtetutën në një mënyrë që ndikon në të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Gjykata gjithashtu përmend përgjigjen e Avokatit të Popullit, të shqyrtuar më herët në këtë Aktgjykim, si dhe propozimin e tij se Avokati i Popullit duhet të ketë të drejtë të rizgjidhet.
242. Siç u tha më sipër, me rastin e shqyrtimit të postit të Prokurorit të Shtetit, të themeluar me nenin 109 [Prokurori i Shtetit], posti i Avokatit të Popullit është njëri prej posteve të themeluara me Kushtetutë që mund të ushtrohet edhe nga zëvendësit deri në emërimin e Avokatit të ri të Popullit. Prandaj, natyra e këtij posti dallon nga ajo e gjyqtarëve të cilët duhet të ulen për të dëgjuar dhe gjykuar rastet që presin të zgjidhen në gjykata.
243. Përveç kësaj, mund të ketë arsye të mira për ta propozuar mundësinë për rizgjedhjen e Avokatit të Popullit, por ky propozim nuk e ndryshon Kushtetutën në një mënyrë që ndikon në të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 134 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 139.3 të Kushtetutës

244. Neni aktual 139.3 thotë me sa vijon:

“3. Kryesuesin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e emëron Presidenti i Republikës së Kosovës nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatave me jurisdiksion apeli.”

245. Sipas amendamentit të propozuar, neni 139.3 thotë me sa vijon:

“3. Kryesuesin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve e emëron dhe e shkarkon Presidenti i Republikës së Kosovës nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatave me juridiksion apeli.”

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 139.3 të Kushtetutës

246. Gjykata konsideron që ndonëse Presidentit do t'i jepet një rol në lidhje me shkarkimin e kryesuesit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kjo nuk e ndryshon Kushtetutën në një mënyrë që ndikon në të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 139 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

X. Amendamenti 10 i propozuar: [Shpallja e Zgjedhjeve të para Presidenciale] e zëvendëson nenin 162

247. Amendamenti 10 propozon të futet një nen i ri, neni 162 [Shpallja e Zgjedhjeve të para të Presidenciale], i cili përcakton me sa vijon:

“Pavarësisht dispozitave të tjera të kësaj Kushtetute:

- (1) Zgjedhjet për Presidentin e Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 86 të Kushtetutës, mbahen brenda 6 (gjashtë) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të amendamenteve Kushtetuese dhe ligjeve relevante.
- (2) Mandati i Presidentit të Republikës së Kosovës, i zgjedhur nga Kuvendi, sipas dispozitave të mëhershme të Kushtetutës, vazhdon derisa Presidenti i ri të zgjedhet dhe të bëjë betimin.
- (3) Presidentët që kanë shërbyer para hyrjes në fuqi të këtyre amendamenteve, kanë të drejtë të zgjedhen dhe rizgjedhen edhe një herë si President i Republikës së Kosovës.”

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 162.1 të Kushtetutës

248. Gjykata konsideron që mbajtja e zgjedhjeve të para presidenciale sipas sistemit të ri zgjedhor, brenda gjashtë (6) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të amendamenteve kushtetuese dhe ligjeve përkatëse, ia shkurton Presidentes aktuale mandatin prej pesë (5) vjetësh.
249. Me rastin e shqyrtimit të formulimit të nenit të ri të propozuar 86, të shqyrtuar më sipër, Gjykata konkludoi që zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës nga qytetarët me të drejtë vote është përmirësim i të drejtave të tyre demokratike dhe nuk pakëson të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.
250. Prandaj, çështja që duhet të shqyrtohet është nëse ndërprerja e parakohshme e mandatit të Presidentes aktuale prej pesë (5) vjetësh, të shkaktuar nga futja e sistemit të ri zgjedhor, pakëson apo nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.
251. Neni 83 [Statusi i Presidentit] thotë me sa vijon:
- “Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikë së Kosovës.”*
252. Me Vendimin Nr. 04-V-227 për zgjedhjen e Presidentit të Republikës, të 7 prillit 2011, Kuvendi vendosi që (1) Shkëlqesia e saj, znj. Atifete Jahjaga zgjedhet Presidente e Republikës, dhe (2) Mandati i Presidentit është pesë (5) vjet.
253. Ky Vendim iu dërgua Kryesisë së Kosovës, Qeverisë së Kosovës dhe arkivit të Kuvendit. Më 7 prill 2011, Shkëlqesia e saj, znj. Atifete Jahjaga mori përsipër mandatin e saj si Presidente e Republikës, duke dhënë betimin para Kuvendit, në pajtim me nenin 87 të Kushtetutës.
254. Që nga data e zgjedhjes së Presidentit të Republikës nga Kuvendi, ajo u bë përfaqësuese legjitime e vendit, brenda dhe jashtë, si dhe garantuese e funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, siç parashihet me Kushtetutë.
255. Në rastin e Presidentes aktuale të Republikës, kjo do të thotë që i gjithë populli i Kosovës pret që ajo të jetë Presidentja e tyre gjatë pesë (5) vjetëve të ardhme. Kështu që, shkurtimi i mandatit të saj, siç propozohet me amendamentin 10, e privon popullin e Kosovës nga përfaqësuesi i tyre legjitim dhe garantuesi në një kohë më të hershme se që besonin dhe shpresonin.

256. Autoriteti i Presidentit buron, para së gjithash, nga populli, të cilët përmes përfaqësuesve të tyre të zgjedhur në mënyrë demokratike në Kuvend e zgjedhin atë. Në rrethet e parë të votimit, Presidenti duhet t'i fitojë dy të tretat e shumicës së deputetëve të Kuvendit. Në rrethin e tretë, nëse është nevoja të mbahet, Presidenti mund të zgjidhet me shumicën e të gjithë deputetëve të Kuvendit. Presidentja aktuale u zgjodh me shumicën dërrmuese të të gjithë deputetëve të Kuvendit që në rrethin e parë.
257. Neni 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] i Kushtetutës thotë që *“Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit ... [dhe] ... është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë.”* Ky formulim sa i përket rolit të Presidentit është kryesor për njërin prej parimeve themelore të Kushtetutës së Kosovës, pra i doktrinës së ndarjes së pushtetit.
258. Kjo Gjykatë e theksoi këtë parim në Aktgjykimin e vet në Rastin Nr. KO 98/11, të 20 shtatorit 2011, lidhur me imunitetet e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në paragrafin 44, me ç'rast Gjykata tha:
- “Republika e Kosovës definohet nga Kushtetuta e vet si Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre. Ndarja e pushteteve është njëra prej bazave që garanton funksionim demokratik të shtetit. Esenca e funksionimit të pavarur dhe efektiv të këtyre degëve është imuniteti që u është dhënë njerëzve që i mishërojnë këto pushtete.”*
259. Pasi të zgjidhet, Presidenti mban mandatin deri në pesë vjet. Presidentja aktuale mban mandatin në mënyrë legjitime dhe është, në bazë të zgjedhjes së saj Presidente, garantuese e funksionimit demokratik të institucioneve në shtet. Mandati i Presidentit të Kosovës është përzierje e legjitimitetit të zgjedhjes së tij/saj, kohëzgjatjes së mandatit (pesë vjet) dhe kompetencave që i jepen Presidentit me Kushtetutë, jo vetëm kompetencat e dhëna sipas nenit 84 [Kompetencat e Presidentit].
260. Natyra e mandatit të Presidentit është edhe e natyrës politike që buron nga e drejta pasive e Presidentit për t'u zgjedhur, e garantuar me nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes], e posaçërisht me nenin 45.1, i cili thotë që të gjithë qytetarët gëzojnë të drejtën të zgjedhen. Instrumentet ndërkombëtare që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në Kosovë sipas nenit 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] përfshijnë Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (në tekstin e mëtejshëm: KNDCP), ku e drejta e njëjtë është theksuar në nenin 25, i cili përcakton:

“Çdo qytetar ka të drejtë dhe mundësi, që pa asnjë nga dallimet e përmendura në nenin 2 dhe pa kufizime të paarsyeshme:

- (a) Të marrë pjesë në drejtimin e punëve publike, qoftë drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur lirisht;*
- (b) Të votojë dhe të zgjedhet gjatë zgjedhjeve të vërteta të herëpashershme, me votim të përgjithshëm dhe të barabartë dhe me vota të fshehta, të cilat sigurojnë shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve;*

(c) Të pranohet, në kushte të përgjithshme barazie, për të ushtruar funksione publike në vendin e tij.”

261. Gjykata vëren që shprehja “*të marrë pjesë në drejtimin e punëve publike*” në nenin 25 (a) të KNDCP-së është kryesore për ushtrimin e mandatit të Presidentit të zgjedhur në mënyrë të drejtë e legjitime sipas Kushtetutës si pjesë e detyrave të tij/saj, siç parashihet me nenin 4, të cituar më lart.
262. Në të vërtetë, mund të thuhet që shprehja “*(c) Të pranohet, në kushte të përgjithshme barazie, për të ushtruar funksione publike në vendin e tij*” mund të zbatohet për postin e Presidentes së Republikës sipas kritereve aktuale të Kushtetutës, pasi barazia nënkupton të drejtën, krahas cilitdo person të trajtuar në mënyrë të padrejtë, për të pasur mjete efektive sipas ligjit për shkak të shkurtimit të mandatit. Sikur amendamenti i propozuar të miratohej, Presidentja aktuale nuk do të kishte qasje mjete të tilla.
263. Nëse Presidenti në detyrë nuk ka mbrojtje efektive juridike për shkak të shkurtimit të mandatit, atëherë rrezikohet mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. E drejta në mjet efektiv juridik është e mishëruar në nenin 54 të Kapitullit II të Kushtetutës, i cili përcakton:

“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.”

264. Kjo e drejtë më tej mbrohet me nenin 13 të Konventës, i cili përcakton:

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”

265. Për më tepër, ushtrimi i këtyre të drejtave themelore është i garantuar me dispozitat e barazisë, të cilat gjithashtu i mbështesin normat e Kushtetutës, jo vetëm neni 24 [Barazia para Ligjit], i cili në paragrafin 1, ndër të tjera, thotë që “*Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim*”. Kjo gjithashtu vlen, detyrimisht, për mbrojtjen e mandatit të Presidentit.
266. Kapitulli II i Kushtetutës përfshin shumë të drejta të tjera dhe liri themelore të njeriut në të cilat kjo Gjykatë, në këtë fazë, nuk duhet të thirret apo t’i shtjellojë tutje me rastin e marrjes së vendimit në lidhje me këtë amendament të propozuar, si ato të përcaktuara në nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] dhe në nenin 46 [Mbrojtja e Pronës].
267. Gjykata e shqyrtoi çështjen e mandatit të mbajtësve të posteve kushtetuese edhe në Aktgjykimin e sipërpërmendur në Rastin Nr. KO 98/11, në paragrafët 87 dhe 88:

“87. Në nenin 66 të Kushtetutës përdoret shprehja “mandat” për ta përshkruar kohëzgjatjen e legjislaturës përkatëse. Në të thuhet që mandati katërvjeçar fillon me seancën konstituive të mbajtur pas shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve dhe përfundon me shpërndarjen e Kuvendit.

88. Kushtetuta gjithashtu përdor shprehjen “mandat” në lidhje me deputetët e Kuvendit me ç’rast ata, si përfaqësues të popullit, nuk i nënshtrohen asnjë

mandati detyruet. Secili deputet ka mandat individual, i cili fillon në ditën e certifikimit të rezultatit të zgjedhjes. Në ndërkohë që mandati i Kuvendit fillon me seancën konstituive të Kuvendit të sapozgjedhur, mandati i deputetit mund të fillojë më herët. Mandati i deputetit mbaron me shfaqjen e cilësdo prej rrethanave të cekura në nenin 70 (3) të Kushtetutës. Mandati i deputetit mishëron funksionin e tij/saj përfaqësues.”

268. Vënia e theksit mbi rëndësinë dhe atributet e mandatit lidhej ngushtë me arsyetimin e Gjykatës në atë Aktgjykim se imuniteti ishte i pandashëm nga mandati. Mandati bazohej në Kushtetutë. Kështu është edhe me mandatin e Presidentit. Ai mandat është i panecueshëm për të siguruar respektim të parimit të ndarjes së pushteteve dhe për ta ruajtur sigurinë në rendin juridik dhe kushtetues.
269. Përveç kësaj, ndërprerja e parakohshme e mandatit të Presidentit të Republikës është ngjarje që është paraparë me nenin 91 të Kushtetutës [Shkarkimi i Presidentit] vetëm në rrethana të kufizuara, si dënimi për shkak të kryerjes së veprës së rëndë, për shkak të sëmundjes së rëndë apo për shkak të shkeljes së rëndë të Kushtetutës.
270. Megjithatë, ndërprerja e parakohshme e mandatit të Presidentit, siç parashihet me amendamentin e propozuar, ndikon në parimet themelore kushtetuese, në veçanti, parimin e ndalimit të shkurtimit të mandatit të fituar ligjërisht të postit kushtetues, si dhe parimin e mbrojtjes së besimit të arsyetuar të qytetarëve në ligjet e Kosovës dhe të zgjedhjes dhe mandatit të Presidentit të tyre duke u bazuar në ato ligje.
271. Për shkak të të gjitha arsyeve të përmendura më sipër, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar, me të cilin shkurtohet mandati i Presidentes aktuale të Republikës, pakëson të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 162.2 të Kushtetutës

272. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar ia vazhdon mandatin Presidentit të zgjedhur nga Kuvendi deri në betimin e Presidentit të ri sipas dispozitave të reja dhe kjo nuk e ndryshon Kushtetutën në një mënyrë që ndikon në të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 162.2 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 162.3 të Kushtetutës

273. Gjykata konsideron që amendamenti propozon t'u lejohet Presidentëve të mëparshëm të zgjidhen dhe rizgjidhen dhe kjo nuk e ndryshon Kushtetutën në një mënyrë që ndikon në të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 162.3 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

XI. Amendamenti 11 i propozuar: neni 162

Sa i përket amendamentit të propozuar që neni ekzistues 162 i Kushtetutës të bëhet neni 163:

274. Neni aktual 162 thotë me sa vijon:

“Kushtetuta e Republikës së Kosovës hyn në fuqi më 15 qershor 2008.”

275. Sipas amendamentit të propozuar, neni me numër 163 thotë me sa vijon:

“Kushtetuta e Republikës së Kosovës hyn në fuqi më 15 qershor 2008. Amendamentet 1-11 të kësaj Kushtetute hynë në fuqi ditën e miratimit në Kuvendin e Kosovës. Pas hyrjes në fuqi të amendamenteve Kushtetuese bëhet harmonizimi i ligjeve dhe akteve të tjera të përgjithshme.”

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 162 të Kushtetutës

276. Gjykata konsideron që ndryshimeve të propozuara të Kushtetutës u jepet fuqi juridike pas miratimit në Kuvendin e Kosovës dhe që kjo nuk e ndryshon Kushtetutën në një mënyrë që ndikon në të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 162 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 113.9 dhe nenit 144.3 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe rregullit 56.1 të Rregullores së punës,

GJYKATA NJËZËRI VENDOSI ME SA VIJON:

- I. Kërkesat e dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit më 23 mars 2012 dhe më 4 maj 2012, me amendamentet e propozuara të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (të paraqitura në Aneksin A dhe B) janë të pranueshme;
- II. Amendamentet e propozuara të paraqitura në Aneksin B i kanë përfshirë ato në Aneksin A dhe ky Aktgjykim i referohet vetëm Aneksit B;
- III. Amendamentet e propozuara në vijim pakësojnë të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës :
 1. Neni i ri i propozuar 85.2 (Në lidhje me kufizimin e të drejtës për të qenë kandidat për President vetëm për qytetarët që kanë qenë banorë të përhershëm të Republikës së Kosovës për pesë vjet);
 2. Neni i ri i propozuar 86.3 (Në lidhje me propozimet për postin e Presidentit të Kosovës – sepse ka të bëjë vetëm me subjektet politike parlamentare që e kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet e fundit);
 3. Neni i ri i propozuar 90.5 (2) (Në lidhje me kufizimin e kompetencave të Ushtruesit të Detyrës së Presidentit për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme);
 4. Neni i ri i propozuar 90.5 (3) (Në lidhje me kufizimin e kompetencave të Ushtruesit të Detyrës së Presidentit për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve);
 5. Neni i ri i propozuar 90.5 (5) (Në lidhje me kufizimin e kompetencave të Ushtruesit të Detyrës së Presidentit për shpalljen e faljeve);
 6. Neni i ri i propozuar 104.1 (Në lidhje me veton pezulluese të Presidentit për emërimin e gjyqtarëve të gjykatave të rregullta);
 7. Neni i ri i propozuar 114.2 (Në lidhje me veton pezulluese të Presidentit për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese);
 8. Neni i ri i propozuar 162.1 (Në lidhje me ndërprerjen e parakohshme të mandatit Presidentit të Republikës së Kosovës);
- IV. Ky Aktgjykim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- V. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani

ANEKS A



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi-Skupština-Assembly

KOMISIONI PËR AMANDAMENTIMIN E KUSHTETUTËS

PAKOJA E AMANDAMENTEVE KUSHTETUTESE

19 Mars 2012

Amandamenti 1

Neni 84 [Kompetencat e Presidentit] amandamentohet si vijon:

Presidenti i Republikës së Kosovës:

- (1) përfaqëson Republikën e Kosovës ~~brenda dhe jashtë~~;
- (2) garanton funksionimin kushtetues të institucioneve të përcaktuara me këtë Kushtetutë;
- (3) shpall zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës dhe thërret mbledhjen e parë të tij;
- (4) nxjerr dekrete në pajtim me këtë Kushtetutë;
- (5) shpall ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;
- (6) ka të drejtën e kthimit për rishqyrtim të ligjeve të miratuara, nëse konsideron se janë të dëmshme për interesat legjitime të Republikës së Kosovës ose të një a më shumë komuniteteve të saj. Të drejtën e rikthimit të një ligji mund ta shfrytëzojë vetëm një herë
- (7) nënshkruan marrëveshjet ndërkombëtare në pajtim me këtë Kushtetutë;
- (8) propozon amendamente për këtë Kushtetutë;

(9) ~~mund të referojë~~ ngritë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me këtë Kushtetutë;

(10) ~~udhëheq~~ bashkëpunon me Qeverinë në lidhje me politikën e jashtme të vendit;

(11) pranon letrat kredenciale të shefave të misioneve diplomatike të akredituar në Republikën e Kosovës;

(12) është Komandant Suprem i Forcave të Sigurisë të Kosovës;

(13) udhëheq Këshillin Konsultativ për Komunitete;

(14) cakton mandatarin për formimin e Qeverisë, pas propozimit të partisë politike ose të koalicionit, që përbën shumicën në Kuvend;

(15) emëron dhe shkarkon Kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës, me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;

(16) emëron dhe shkarkon gjyqtarët e Republikës së Kosovës, me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;

(17) emëron dhe shkarkon Kryeprokurorin e Shtetit të Republikës së Kosovës, me propozimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës;

(18) emëron dhe shkarkon prokurorët e Republikës së Kosovës, me propozimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës;

(19) emëron gjyqtarët për Gjykatën Kushtetuese, me propozimin e Kuvendit;

(20) emëron Komandantin e Forcave të Sigurisë të Kosovës, pas rekomandimit nga ana e Kryeministrit;

(21) së bashku me Kryeministrin, emëron Drejtorin dhe Zëvendësdrejtorin dhe Inspektorin e Përgjithshëm e Agjencisë së Kosovës për Intelegjencë;

(22) ~~vendos për~~ shpall Gjendjen e Jashtëzakonshme, pasi të njoftojë në konsultimit me Kryeministrin;

(23) ~~mund të kërkojë kryeson~~ mbledhjet e Këshillin e Sigurisë të Kosovës; ~~dhe i kryeson ato në kohën e Gjendjes së Jashtëzakonshme;~~

(24) ~~vendos për formimin-e themelon~~ misionet diplomatike e konsullore të Republikës së Kosovës, ~~në bazë të konsultimit me~~ me propozim të Qeverisë;

(25) emëron dhe shkarkon shefat e misioneve diplomatike të Republikës së Kosovës, me propozim të Qeverisë;

(26) emëron Kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në pajtim me këtë Kushtetutë;

(27) emëron dhe shkarkon Guvernatorin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës i cili shërben edhe si Drejtor Menaxhues dhe emëron anëtarët e tjerë të Bordit të Bankës;

(28) jep medalje, mirënjohje dhe çmime, në pajtim me ligjin;

(29) shpall falje individuale, në pajtim me ligjin;

(30) së paku një herë në vit i drejtohet Kuvendit të Kosovës përkitazi me ~~me~~ fushëveprimtarinë e tij/saj gjendjen në Republikën e Kosovës;

(31) emëron Ombudspersonin, me propozim të Kuvendit;

(32) kryen edhe detyra të tjera, të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj.

Amandamenti 2

[Neni 85 - Kualifikimet për Zgjedhjen e Presidentit] fshihet dhe zëvendësohet si vijon:

1. President i Republikës së Kosovës mund të jetë secili shtetas i Republikës së Kosovës, i cili në momentin e kandidimit e ka mbushur moshën 35 (tridhjetë e pesë) vjeçare.

2. Për t'u kualifikuar si kandidat për President, secili shtetas i Republikës së Kosovës duhet të ketë qenë banor i përhershëm i Republikës së Kosovës gjatë pesë viteve të fundit para kandidimit për President.

3. Para dhënies së betimit si President i Republikës së Kosovës, kandidati i zgjedhur President duhet të japë dorëheqje nga çdo post publik.

4. Përveç kushteve të përcaktuara në këtë nen, kandidatët për President duhet të përmbushin edhe kushtet e tjera të përcaktuara me ligj.

Amandamenti 3

[Neni 86 - Kandidimi dhe Zgjedhja e Presidentit] fshihet dhe zëvendësohet si vijon:

1. Presidenti i Republikës së Kosovës zgjedhet drejtpërdrejt nga qytetarët me të drejtë vote.

2. Zgjedhjet Presidenciale shpallen nga Kryetari i Kuvendit, jo më vonë se gjashtë muaj para përfundimit të mandatit të rregullt të Presidentit të Republikës së Kosovës.

3. Secili shtetas i Republikës së Kosovës, që i plotëson kushtet e përcaktuara në këtë Kushtetutë, mund të kandidohet për President: (a) nga subjektet politike parlamentare, që, në pajtim me ligjin, kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet e fundit; (b) nga subjektet politike që mbajnë ulëse të garantuara në Kuvend dhe (c) përmes petitionit të dorëzuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, me nënshkrimet e së paku 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) votuesve të kualifikuar në Republikën e Kosovës. Një subjekt politik parlamentar mund të kandidojë vetëm një kandidat. Procesi i kandidimit bëhet sipas afateve kohore dhe procedurave të përcaktuara me ligj.

4. Nëse kandidati për President merr shumicën absolute (më shumë se 50%) të votave të vlefshme në rrethin e parë, atëherë zgjedhet President i Republikës së Kosovës. Nëse asnjë kandidat nuk merr shumicën absolute të votave në rrethin e parë, mbahet rrethi i dytë i zgjedhjeve në mes të dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave në rrethin e parë. Rrethi i dytë i zgjedhjeve mbahet jo më vonë se 30 ditë nga rrethi i parë. Kandidati, i cili merr shumicën e votave në rrethin e dytë të zgjedhjeve, zgjedhet President i Republikës së Kosovës.

Amandamenti 4

[Neni 87 - Mandati dhe Betimi] fshihet dhe zëvendësohet si vijon:

1. Mandati i Presidentit të Republikës së Kosovës është 5 (pesë) vjet dhe fillon pasi që kandidati i zgjedhur të ketë dhënë betimin.

2. Presidenti betohet para Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese në një vend publik të përcaktuar me ligj. Teksti i betimit është:

“Beto hem se me tërë qenien time do të ruaj dhe mbroj pavarësinë, sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës së Kosovës, garantimin e të drejtave dhe lirive për të gjithë qytetarët, respektimin dhe mbrojtjen e Kushtetutës dhe ligjeve, ruajtjen e paqes dhe mirëqenies së të gjithë qytetarëve, do të jem lojal vetëm ndaj Republikës së Kosovës, duke heqë dorë nga të gjitha obligimet ndaj ndonjë shteti tjetër që janë në kundërshtim me përgjegjësitë e miya në Republikën e Kosovës, dhe të përfaqësoj me tërë fuqinë time unitetin e qytetarëve të Republikës së Kosovës.”

3. Presidenti mund të rizgjedhet vetëm për një mandat tjetër.

Amandamenti 5

[Neni 88-Papajftueshmëria] fshihet dhe zëvendësohet si vijon:

1. Presidenti nuk mund të mbajë e as të ushtrojë ndonjë funksion tjetër publik.
2. Presidenti nuk mund të mbajë as të ushtrojë ndonjë funksion në një subjekt politik dhe as të jetë anëtar i ndonjë subjekti politik.

Amandamenti 6

[Neni 89 - Imuniteti] fshihet dhe zëvendësohet si vijon:

Presidenti i Republikës së Kosovës gëzon imunitet nga ndjekja penale dhe paditë civile për veprimet dhe vendimet që janë brenda kompetencave të tij.

Amandamenti 7

[Neni 90 - Mungesa e Përkohshme e Presidentit] fshihet dhe zëvendësohet si vijon:

1. Nëse Presidenti i Republikës së Kosovës përkohësisht nuk është në gjendje të ushtrojë kompetencat e tij, ai mund t'ia kalojë vullnetarisht ushtrimin e kompetencave të tij Kryetarit të Kuvendit, i cili bëhet Ushtrues i Detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës. Vendimi me shkrim i Presidentit për kalimin e përgjegjësive përmban në veçanti arsyet dhe kohëzgjatjen e kalimit të përgjegjësive, nëse kohëzgjatja në fjalë mund të parashikohet. Presidenti i Republikës së Kosovës rifillon ushtrimin e kompetencave të tij kur të jetë në gjendje për të bërë këtë dhe, me këtë rast, Kryetarit të Kuvendit i përfundon posti i Ushtruesit të Detyrës së Presidentit.

2. Nëse Presidenti, për arsye shëndetësore, nuk është në gjendje të ushtrojë kompetencat e tij dhe nuk ka ndodhur kalimi vullnetar i përgjegjësive, Kuvendi i Republikës së Kosovës, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve, mund të fillojë procedurën për të vlerësuar nëse gjendja shëndetësore nuk ia lejon Presidentit ushtrimin e kompetencave të tij. Kuvendi kërkon nga institucioni kompetent shëndetësor të themelojë Konsiliumin e Mjekëve, për të vlerësuar gjendjen shëndetësore të Presidentit, dhe për të dorëzuar raportin në Kuvend. Nëse në raportin e Konsiliumit konstatohet se Presidenti nuk është i aftë për të ushtruar kompetencat e tij, Kuvendi, me 2/3 (dy të tretat) e votave të të gjithë deputetëve, mund të vendosë për zëvendësimin e përkohshëm të Presidentit. Me këtë rast, Kryetari i Kuvendit të Kosovës ushtron detyrën e Presidentit. Presidenti i Republikës së Kosovës në çdo kohë mund të kërkojë vlerësimin të ri të gjendjes shëndetësore dhe të kthehet në detyrë, nëse Konsiliumi i Mjekëve konstaton se Presidenti është i aftë që të rifillojë ushtrimin e kompetencave të tij.

3. Nëse për çfarëdo arsye tjetër, përveç asaj shëndetësore, Presidenti i Republikës së Kosovës nuk është në gjendje për të ushtruar kompetencat e tij dhe nuk ka ndodhur kalimi vullnetar i përgjegjësive, Kuvendi i Republikës së Kosovës, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve, mund të fillojë procedurën për zëvendësimin e përkohshëm të Presidentit. Nëse Kuvendi vendos me 2/3 (dy të tretat) e votave të të gjithë deputetëve se Presidenti përkohësisht nuk është në gjendje të ushtrojë kompetencat e tij, Kryetari i Kuvendit do të ushtrojë detyrën e Presidentit, derisa Presidenti i Republikës së Kosovës të jetë i aftë të rifillojë ushtrimin e kompetencave.

4. Përveç nëse nuk përcaktohet ndryshe me këtë Kushtetutë, posti i Ushtruesit të Detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës nuk mund të ushtrohet për një periudhë më të gjatë se 6 (gjashtë) muaj.

5. Ushtruesi i detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës ushtron të gjitha kompetencat e Presidentit me përjashtim të:

- (1) propozimin e amandamenteve Kushtetuese;
- (2) shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, pa miratimin e Kryeministrit;
- (3) emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve të Republikës së Kosovës;
- (4) emërimin dhe shkarkimin e shefave të misioneve diplomatike të Republikës së Kosovës;
- (5) shpalljen e faljeve individuale, dhe
- (6) dhënien e medaljeve, mirënjohjeve dhe të çmimeve.

6. Nëse Presidenti i Republikës së Kosovës nuk është në gjendje për të ushtruar kompetencat e tij për 6 (gjashtë) muaj, Ushtruesi i Detyrës së Presidentit menjëherë shpall vakant postin e Presidentit dhe shpall zgjedhjet e parakohshme për President, të cilat mbahen jo më vonë se 3 (tre) muaj pas mbetjes së postit të Presidentit vakant. Ushtruesi i Detyrës së Presidentit vazhdon ta ushtrojë kompetencat e Presidentit, derisa Presidenti i ri të zgjedhet dhe të bëjë betimin.

7. Nëse Konsiliumi i Mjekëve konstaton se Presidenti i Republikës së Kosovës nuk do të jetë në gjendje të ushtrojë kompetencat e tij për një periudhë më të gjatë se 6 (gjashtë) muaj, Kuvendi, me votën e 2/3 e të gjithë deputetëve, e shpall vakant postin e Presidentit. Ushtruesi i Detyrës së Presidentit menjëherë shpall zgjedhjet e parakohshme për President, të cilat mbahen jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita kur Kuvendi ka shpallur vakant postin e Presidentit. Ushtruesi i Detyrës së Presidentit vazhdon të ushtrojë kompetencat e Presidentit, derisa Presidenti i ri të zgjedhet dhe të bëjë betimin.

Amandamenti 8

[Neni 91 - Dorëheqja, shkarkimi dhe vdekja Presidentit] fshihet dhe zëvendësohet si vijon:

1. Presidenti i Republikës së Kosovës jep dorëheqje përmes dorëzimit të letër dorëheqjes te Kryetari i Gjykatës Kushtetuese. Dorëheqja është e vlefshme në momentin e pranimit të letër dorëheqjes nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese dhe është e përvokueshme.

2. Presidenti i Republikës së Kosovës mund të shkarkohet nga detyra, nëse ai dënohet për kryerjen e krimit të rëndë gjatë ushtrimit të detyrës, ose nëse Gjykata Kushtetuese konstaton se ai ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës, ose nëse kryen akt të tradhtisë ndaj shtetit.

3. Procedura për shkarkimin e Presidentit të Republikës së Kosovës, për rastet e specifikuar në paragrafin 2 të këtij neni, mund të fillohet nga 1/3 (një e treta) e deputetëve të Kuvendit, ose nga 30.000 (tridhjetë mijë) qytetarë me të drejtë vote. Para se të dorëzohet në Gjykatën Kushtetuese për shqyrtim, peticioni duhet të miratohet me 2/3 (dy të tretat) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.

4. Nëse Gjykata Kushtetuese, me votat e së paku 7 (shtatë) gjyqtarëve, merr vendim se Presidenti i Republikës së Kosovës është përgjegjës për cilëndo nga arsyet e specifikuar në paragrafin 2 të këtij neni, Presidenti konsiderohet i shkarkuar nga detyra.

5. Në rast se Presidenti i Republikës së Kosovës jep dorëheqje, shkarkohet në përputhje me dispozitat e këtij neni, ose vdes, Kryetari i Kuvendit të Kosovës shërben si Ushtrues i Detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, në përputhje me kufizimet e përcaktuara në nenin 90, derisa të zgjedhet dhe të bëjë betimin Presidenti i ri. Kryetari i Kuvendit menjëherë shpall zgjedhjet e parakohshme për President të Republikës së Kosovës, të cilat mbahen jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita kur posti i Presidentit ka mbetur vakant.

6. Nëse Kryetari i Kuvendit, për ndonjë nga arsyet e përcaktuara në nenin 90 dhe 91, nuk është në gjendje të shërbejë si Ushtrues i Detyrës së Presidentit, kjo detyrë kalon te Nënkryetari i Kuvendit. Çështjet e tjera rreth bartjes së përgjegjësisë së ushtrimit të detyrës së Presidentit rregullohen me ligj.

Amendamenti 9

Nenet e mëposhtme të Kushtetutës së Republikës së Kosovës amendamentohen si vijon:

Neni 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare]

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës, me votat e dy të tretave (2/3) e të gjithë deputetëve, ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare për këto çështje:

(1) territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake;

(2) të drejtat dhe liritë themelore;

(3) anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare;

(4) marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga ana e Republikës së Kosovës, **në pajtim ligjin.**

2. Marrëveshjet ndërkombëtare, me përjashtim të atyre në pikën 1, **konsiderohen të ratifikuara ratifikohen** pas nënshkrimit nga Presidenti i Republikës së Kosovës, _____ **Qeverisë.**

3. Presidenti i Republikës së Kosovës ose **Kryeministri Qeveria** njoftojnë Kuvendin sa herë që të nënshkruhet një marrëveshje ndërkombëtare.

4. Amendamenti ose tërheqja nga marrëveshjet ndërkombëtare do të kenë të njëjtën procedurë të vendimmarrjes, sikur ajo e ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare.

5. Parimet dhe procedurat për ratifikimin dhe kontestimin e marrëveshjeve ndërkombëtare rregullohen me ligj.

Neni 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes], paragrafi 1, amandamentohet si vijon:

1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor, **ose me dispozitat e kësaj Kushtetute.**

Neni 65 [Kompetencat e Kuvendit] Paragrafi 7, amendamentohet si vijon:

7) ~~zgjedh dhe mund të shkarkojë~~ **Dorëzon në Gjykatën Kushtetuese peticionin për shkarkimin** e Presidentit të Republikës së Kosovës, _____ **pajtim** të Kushtetutës;

Neni 82 [Shpërndarja e Kuvendit] shfuqizohet paragrafi 1 (3)

~~(3) nëse brenda afatit prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga dita e fillimit të procedurës së zgjedhjes, nuk zgjedhet Presidenti i Republikës së Kosovës.~~

Neni 93 [Kompetencat e Qeverisë]

(10) ~~mund të referojë~~ **ngritë** çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese, **në pajtim me këtë Kushtetutë;**

(12) i propozon Presidentit themelimin e misioneve diplomatike e konsullore të Republikës së Kosovës;

(13) udhëheq politikën e jashtme të vendit;

Neni 94 [Kompetencat e Kryeministrit]

(5) ~~kryeson~~ **është anëtar** i Këshillit të Sigurisë të Kosovës;

~~(9) këshillohet me Presidentin për zbatimin e udhëheq politikën e jashtme të vendit;~~

Neni 104 [Emërimi dhe Shkarkimi i Gjyqtarëve]

1. Gjyqtarët i emëron, riemëron dhe shkarkon Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. **Presidenti mund të rikthejë kandidatin e propozuar për rishqyrtim në K Gjyqësor**
Këtë të drejtë mund ta ushtrojë vetëm një herë për një kandidat. Këshilli Gjyqësor i Kosovës mund të propozojë kandidatin e njëjtë vetëm nëse siguron mbështetjen (dy ë tretat) _____

Neni 109 [Prokurori i Shtetit]

7. Kryeprokurori i Shtetit emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, në bazë të propozimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. **Presidenti mund të rikthejë kandidatin e propozuar për rishqyrtim në _____ drejtë ushtrojë një për një _____ propozojë _____ njëjtë, siguron mbështetjen (dy ë tretave) _____**
_____ Mandati i Kryeprokurorit të Shtetit është shtatë (7) vjet, pa mundësi riemërimi.

Neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

Paragrafi 3 (5) amendamentohet si vijon:

5. Nëse është shkelur Kushtetuta gjatë zgjedhjes së Presidentit dhe Kuvendit.

Paragrafi 6 amendamentohet si vijon:

6. (tridhjetë) a më shumë deputetë të Kuvendi i Kosovës është i autorizuar të dorëzojë peticionin, me të cilin kërkohet shkarkimi i Presidentit të Republikës së Kosovës në përputhje me nenin 91 të Kushtetutës. ~~ka kryer shkelje serioze të Kushtetutës.~~

Neni 127 [Këshilli i Sigurisë i Kosovës]

2. Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës kryesohet nga Kryeministri Presidenti i Republikës së Kosovës, me mbështetie nga Qeveria. ~~-përveç gjatë periudhës së Gjendjes së Jashtëzakonshme, sikurse është parashikuar me këtë Kushtetutë.~~

Neni 131 [Gjendja e Jashtëzakonshme]

8. Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës, vetëm gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, ushtron funksione ekzekutive që kufizohen në funksionet që ndërlidhen në veçanti me Gjendjen e Jashtëzakonshme. ~~Gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës do të drejtohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, sikur rregullohet me ligj.~~ Gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës do të bashkëpunojë ngushtë me Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet ndërkombëtare.

Neni 134 [Kualifikimi, Zgjedhja Emërimi dhe Shkarkimi i Avokatit të Popullit]

1. Avokati i Popullit e ~~zgjedh Kuvendi i Kosovës, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të tij,~~ nga Presidenti, ~~propozim~~ për një mandat pesë (5) vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje. P kthejë kandidatin e propozuar nga Kuvendi. Këtë të drejtë mund ta ushtrojë vetëm një herë për një kandidat. Kuvendi mund të propozojë kandidatin e njëjtë, vetëm nëse siguron mbështetjen e 2/3 (dy të tretave) të votave të të gjithë deputetëve.

~~5. Avokati i Popullit mund të shkarkohet vetëm me kërkesën e më shumë se një të tretës (1/3) së të gjithë deputetëve, dhe në këtë rast nga Kuvendi vendos me shumicën e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të tij.~~

Neni 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve]

3. Kryesuesin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e emëron **dhe e shkarkon** Presidenti i Republikës së Kosovës nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatave me juridiksion apeli.

Amendamenti 10

[Shpallja e Zgjedhjeve të para Presidenciale], zëvendëson nenin ekzistues 162, si vijon:

Pavarësisht dispozitave të tjera të kësaj Kushtetute:

1. Zgjedhjet për Presidentin e Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 86 të Kushtetutës, mbahen brenda 6 (gjashtë) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të amendamenteve Kushtetuese dhe ligjeve relevante.
2. Mandati i Presidentit të Republikës së Kosovës, i zgjedhur nga Kuvendi, sipas dispozitave të mëhershme të Kushtetutës, vazhdon derisa Presidenti i ri të zgjedhet dhe të bëjë betimin.
3. Presidentët që kanë shërbyer para hyrjes në fuqi të këtyre amendamenteve, kanë të drejtë të zgjedhen dhe rizgjedhen edhe një herë si President i Republikës së Kosovës.

Amendamenti 11

Neni ekzistues 162 [Hyrja në Fuqi], bëhet neni 163 dhe amendamentohet si vijon:

Kushtetuta e Republikës së Kosovës hyn në fuqi më 15 qershor 2008. Amandamentet 1-11 të kësaj Kushtetute hynë në fuqi ditën e miratimit në Kuvendin e Kosovës. **Pas hyrjes në fuqi të amendamenteve Kushtetuese bëhet harmonizimi i ligjeve dhe i akteve të tjera të përgjithshme.**

ANEKS B



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO	
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS	
SKUPSTINA REPUBLIKE KOSOVA	
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO	
Zyra për Propozime dhe Parashitje-Konciliumi za Predloge i Predstevka-Table Office	
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No:	04/2383/Do-993/1
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages:	Data Datum Date: 04.05.2012
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA	

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi-Skupština-Assembly

KOMISIONI PËR AMENDAMENTIMIN E KUSHTETUTËS

PAKOJA E AMENDAMENTEVE KUSHTETUTESE

04 Maj 2012

Amendamenti 1

Neni 84 [Kompetencat e Presidentit] amendamentohet si vijon:

Presidenti i Republikës së Kosovës:

- (1) përfaqëson Republikën e Kosovës **brenda dhe jashtë;**
- (2) garanton funksionimin kushtetues të institucioneve të përcaktuara me këtë Kushtetutë;
- (3) shpall zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës dhe thërret mbledhjen e parë të tij;
- (4) nxjerr dekrete në pajtim me këtë Kushtetutë;
- (5) shpall ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;
- (6) ka të drejtën e kthimit për rishqyrtim të ligjeve të miratuara, nëse konsideron se janë të dëmshme për interesat legjitime të Republikës së Kosovës ose të një a më shumë komuniteteve të saj. Të drejtën e rikthimit të një ligji mund ta shfrytëzojë vetëm një herë
- (7) nënshkruan marrëveshjet ndërkombëtare në pajtim me këtë Kushtetutë;
- (8) propozon amendamente për këtë Kushtetutë;
- (9) ~~mund të referojë~~ **ngre** çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese, **në pajtim me këtë Kushtetutë;**
- (10) ~~udhëheq~~ **bashkëpunon me Qeverinë në lidhje me** politikën e jashtme të vendit;
- (11) pranon letrat kredenciale të shefave të misioneve diplomatike të akredituar në Republikën e Kosovës;

- (12) është Komandant Suprem i Forcave të Sigurisë të Kosovës;
- (13) udhëheq Këshillin Konsultativ për Komunitete;
- (14) cakton mandatarin për formimin e Qeverisë, pas propozimit të partisë politike ose të koalicionit, që përbën shumicën në Kuvend;
- (15) emëron dhe shkarkon Kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës, me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- (16) emëron dhe shkarkon gjyqtarët e Republikës së Kosovës, me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- (17) emëron dhe shkarkon Kryeprokurorin e Shtetit të Republikës së Kosovës, me propozimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- (18) emëron dhe shkarkon prokurorët e Republikës së Kosovës, me propozimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- (19) emëron gjyqtarët për Gjykatën Kushtetuese, me propozimin e Kuvendit;
- (20) emëron Komandantin e Forcave të Sigurisë të Kosovës, pas rekomandimit nga ana e qeverisë;
- (21) ~~së bashku me Kryeministrin~~, emëron Drejtorin ~~dhe Zëvendësdrejtorin dhe Inspektorin e Përgjithshëm e~~ Kosovës për Intelejencë;
- (22) ~~vendos për~~ shpall Gjendjen e Jashtëzakonshme, pasi të njoftojë në konsultimit me Kryeministrin;
- (23) ~~mund të kërkojë kryeson~~ mbledhjet e Këshillin e Sigurisë të Kosovës; ~~dhe i kryeson ato në kohën e Gjendjes së Jashtëzakonshme;~~
- (24) ~~vendos për formimin e~~ _____ nisionet diplomatike e konsullore të Republikës së Kosovës në bazë të konsultimit me _____ propozim Qeverisë;
- (25) emëron dhe shkarkon shefat e misioneve diplomatike të Republikës së Kosovës, me propozim të Qeverisë;
- (26) emëron Kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në pajtim me këtë Kushtetutë;
- (27) emëron dhe shkarkon Guvernatorin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, i cili shërben edhe si Drejtor Menaxhues dhe emëron anëtarët e tjerë të Bordit të Bankës;
- (28) jep medalje, mirënjohje dhe çmime, në pajtim me ligjin;
- (29) shpall falje individuale, në pajtim me ligjin;

- (30) **së paku një herë në vit i drejtohet Kuvendit të Kosovës përkitazi me ~~me~~ fushëveprimtarinë e tij/saj gjendjen Republikën**;
- (31) **emëron Ombudspersonin, me propozim të Kuvendit;**
- (32) **krven edhe detyra të tjera, të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj.**

Amendamenti 2

[Neni 85 - Kualifikimet për Zgjedhjen e Presidentit] fshihet dhe zëvendësohet si vijon:

1. President i Republikës së Kosovës mund të jetë secili shtetas i Republikës së Kosovës, i cili në momentin e kandidimit e ka mbushur moshën 35 (tridhjetë e pesë) vjeçare.
2. Për t'u kualifikuar si kandidat për President, secili shtetas i Republikës së Kosovës duhet të ketë qenë banor i përhershëm i Republikës së Kosovës gjatë pesë viteve të fundit para kandidimit për President.
3. Para dhënies së betimit si President i Republikës së Kosovës, kandidati i zgjedhur President duhet të japë dorëheqje nga çdo post publik.
4. Përveç kushteve të përcaktuara në këtë nen, kandidatët për President duhet të përmbushin edhe kushtet e tjera të përcaktuara me ligj.

Amendamenti 3

[Neni 86 - Kandidimi dhe Zgjedhja e Presidentit] fshihet dhe zëvendësohet si vijon:

1. Presidenti i Republikës së Kosovës zgjedhet drejtpërdrejt nga qytetarët me të drejtë vote.
2. Zgjedhjet presidenciale shpallen nga Kryetari i Kuvendit jo më vonë se gjashtë muaj para përfundimit të mandatit të rregullt të Presidentit të Republikës së Kosovës.
3. Secili shtetas i Republikës së Kosovës që i plotëson kushtet e përcaktuara në këtë Kushtetutë, mund të kandidohet për President: (a) nga subjektet politike parlamentare, që, në pajtim me ligjin, kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet e fundit; (b) nga subjektet politike që mbajnë ulëse të garantuara në Kuvend ose (c) përmes peticionit të dorëzuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, me nënshkrimet e së paku 15000 (pesëmbëdhjetë mijë) votuesve të kualifikuar në Republikën e Kosovës. Një subjekt politik parlamentar mund të kandidojë vetëm një kandidat. Procesi i kandidimit bëhet sipas afateve kohore dhe procedurave të përcaktuara me ligj.
4. Nëse kandidati për President merr shumicën absolute (më shumë se 50%) të votave të vlefshme në rrethin e parë, atëherë kandidati në fjalë zgjedhet President i Republikës së Kosovës. Nëse asnjë kandidat nuk merr shumicën absolute të votave në rrethin e parë, mbahet rrethi i dytë i zgjedhjeve në mes të dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave në rrethin e parë. Rrethi i dytë i zgjedhjeve mbahet jo më vonë se 30 ditë nga rrethi i parë. Kandidati, i cili

merr shumicën e votave në rrethin e dytë të zgjedhjeve, zgjedhet President i Republikës së Kosovës.

Amendamenti 4

[Neni 87 - Mandati dhe Betimi] fshihet dhe zëvendësohet si vijon:

1. Mandati i Presidentit të Republikës së Kosovës është 5 (pesë) vjet dhe fillon pasi që kandidati i zgjedhur të ketë dhënë betimin.
2. Presidenti betohet para Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese në një vend publik të përcaktuar me ligj. Teksti i betimit është:

“Betohe se me tërë qenien time do të ruaj dhe mbroj pavarësinë, sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës së Kosovës, garantimin e të drejtave dhe lirive për të gjithë qytetarët, respektimin dhe mbrojtjen e Kushtetutës dhe ligjeve, ruajtjen e paqes dhe mirëqenies së të gjithë qytetarëve, do të jem lojal vetëm ndaj Republikës së Kosovës, duke heqë dorë nga të gjitha obligimet ndaj ndonjë shteti tjetër që janë në kundërshtim me përgjegjësitë e mija në Republikën e Kosovës, dhe të përfaqësoj me tërë fuqinë time unitetin e qytetarëve të Republikës së Kosovës.”

3. Presidenti mund të rizgjedhet vetëm për një mandat tjetër.

Amendamenti 5

[Neni 88-Papajtueshmëria] fshihet dhe zëvendësohet si vijon:

1. Presidenti nuk mund të mbajë e as të ushtrojë ndonjë funksion tjetër publik.
2. Presidenti nuk mund të mbajë as të ushtrojë ndonjë funksion në një subjekt politik dhe as të jetë anëtar i ndonjë subjekti politik.

Amendamenti 6

[Neni 89 - Imuniteti] fshihet dhe zëvendësohet si vijon:

Presidenti i Republikës së Kosovës gëzon imunitet nga ndjekja penale dhe paditë civile për veprimet dhe vendimet që janë brenda kompetencave të tij si President i Republikës së Kosovës.

Amendamenti 7

[Neni 90 - Mungesa e Përkohshme e Presidentit] fshihet dhe zëvendësohet si vijon:

1. Nëse Presidenti i Republikës së Kosovës përkohësisht nuk është në gjendje të ushtrojë kompetencat e tij, ai mund t’ia kalojë vullnetarisht ushtrimin e kompetencave të tij Kryetarit të

Kuvendit, i cili bëhet Ushtrues i Detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës. Vendimi me shkrim i Presidentit për kalimin e përgjegjësive përban në veçanti arsyet dhe kohëzgjatjen e kalimit të përgjegjësive, nëse kohëzgjatja në fjalë mund të parashikohet. Presidenti i Republikës së Kosovës rifillon ushtrimin e kompetencave të tij kur të jetë në gjendje për të bërë këtë dhe, me këtë rast, Kryetari të Kuvendit i përfundon posti i Ushtruesit të Detyrës së Presidentit.

2. Nëse Presidenti, për arsye shëndetësore, nuk është në gjendje të ushtrojë kompetencat e tij dhe nuk ka ndodhur kalimi vullnetar i përgjegjësive, Kuvendi i Republikës së Kosovës, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve, mund të fillojë procedurën për të vlerësuar nëse gjendja shëndetësore nuk ia lejon Presidentit ushtrimin e kompetencave të tij. Kuvendi kërkon nga institucioni kompetent shëndetësor të themelojë Konsiliumin e Mjekëve, për të vlerësuar gjendjen shëndetësore të Presidentit dhe për të dorëzuar raportin në Kuvend. Nëse në raportin e Konsiliumit konstatohet se Presidenti nuk është i aftë për të ushtruar kompetencat e tij, Kuvendi, me 2/3 (dy të tretat) e votave të të gjithë deputetëve, mund të vendosë për zëvendësimin e përkohshëm të Presidentit. Me këtë rast, Kryetari i Kuvendit të Kosovës ushtron detyrën e Presidentit. Presidenti i Republikës së Kosovës në çdo kohë mund të kërkojë vlerësimin të ri të gjendjes shëndetësore dhe të kthehet në detyrë, nëse Konsiliumi i Mjekëve konstaton se Presidenti është i aftë që të rifillojë ushtrimin e kompetencave të tij.

3. Nëse për çfarëdo arsye tjetër, përveç asaj shëndetësore, Presidenti i Republikës së Kosovës nuk është në gjendje për të ushtruar kompetencat e tij dhe nuk ka ndodhur kalimi vullnetar i përgjegjësive, Kuvendi i Republikës së Kosovës, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve, mund të fillojë procedurën për zëvendësimin e përkohshëm të Presidentit. Nëse Kuvendi vendos me 2/3 (dy të tretat) e votave të të gjithë deputetëve se Presidenti përkohësisht nuk është në gjendje të ushtrojë kompetencat e tij, Kryetari i Kuvendit do të ushtrojë detyrën e Presidentit, derisa Presidenti i Republikës së Kosovës të jetë i aftë të rifillojë ushtrimin e kompetencave.

4. Përveç nëse nuk përcaktohet ndryshe me këtë Kushtetutë, posti i Ushtruesit të Detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës nuk mund të ushtrohet për një periudhë më të gjatë se 6 (gjashtë) muaj.

5. Ushtruesi i detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës ushtron të gjitha kompetencat e Presidentit me përjashtim të:

- (1) propozimin e amendamenteve kushtetuese;
- (2) shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, pa miratimin e Kryeministrit;
- (3) emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve të Republikës së Kosovës, të kryeprokurorit dhe të prokurorëve të Republikës së Kosovës;
- (4) emërimin dhe shkarkimin e shefave të misionëve diplomatike të Republikës së Kosovës;
- (5) dhënien e medaljeve, mirënjohjeve dhe të çmimeve në pajtim me ligjin; dhe
- (6) shpalljen e faljeve individuale.

6. Nëse Presidenti i Republikës së Kosovës nuk është në gjendje për të ushtruar kompetencat e tij për 6 (gjashtë) muaj, Ushtruesi i Detyrës së Presidentit menjëherë shpall vakant postin e Presidentit dhe shpall zgjedhjet e parakohshme për President, të cilat mbahen jo më vonë se 3 (tre) muaj pas mbetjes së postit të Presidentit vakant. Ushtruesi i Detyrës së Presidentit vazhdon të ushtrojë kompetencat e Presidentit, derisa Presidenti i ri i zgjedhur të ketë dhënë betimin.

7. Nëse Konsiliumi i Mjekëve konstaton se Presidenti i Republikës së Kosovës nuk do të jetë në gjendje të ushtrojë kompetencat e tij për një periudhë më të gjatë se 6 (gjashtë) muaj, Kuvendi, me votën e 2/3 e të gjithë deputetëve, e shpall vakant postin e Presidentit. Ushtruesi i Detyrës së Presidentit menjëherë shpall zgjedhjet e parakohshme për President, të cilat mbahen jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita kur Kuvendi ka shpallur vakant postin e Presidentit. Ushtruesi i Detyrës së Presidentit vazhdon të ushtrojë kompetencat e Presidentit, derisa Presidenti i ri të zgjedhet dhe të bëjë betimin.

Amendamenti 8

[Neni 91 - Dorëheqja, shkarkimi dhe vdekja e Presidentit] fshihet dhe zëvendësohet si vijon:

1. Presidenti i Republikës së Kosovës jep dorëheqje përmes dorëzimit të letër dorëheqjes te Kryetari i Gjykatës Kushtetuese. Dorëheqja është e vlefshme në momentin e pranimit të letër dorëheqjes nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese dhe është e paravokueshme.

2. Presidenti i Republikës së Kosovës mund të shkarkohet nga detyra, nëse ai dënohet për kryerjen e krimit të rëndë gjatë ushtrimit të detyrës, ose nëse Gjykata Kushtetuese konstaton se ai ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës, ose nëse kryen akt të tradhtisë ndaj shtetit.

3. Procedura për shkarkimin e Presidentit të Republikës së Kosovës, për rastet e specifikuar në paragrafin 2 të këtij neni, mund të fillohet nga 1/3 (një e treta) e deputetëve të Kuvendit ose nga 30000 (tridhjetë mijë) qytetarë me të drejtë vote. Para se të dorëzohet në Gjykatën Kushtetuese për shqyrtim, peticioni duhet të miratohet me 2/3 (dy të tretat) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.

4. Nëse Gjykata Kushtetuese, me votat e së paku 7 (shtatë) gjyqtarëve, merr vendim se Presidenti i Republikës së Kosovës është përgjegjës për cilëndo nga arsyet e specifikuar në paragrafin 2 të këtij neni, Presidenti konsiderohet i shkarkuar nga detyra.

5. Në rast se Presidenti i Republikës së Kosovës jep dorëheqje, shkarkohet në përputhje me dispozitat e këtij neni ose vdes, Kryetari i Kuvendit të Kosovës shërben si Ushtrues i Detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, në përputhje me kufizimet e përcaktuara në nenin 90, derisa të zgjedhet dhe të bëjë betimin Presidenti i ri. Kryetari i Kuvendit menjëherë shpall zgjedhjet e parakohshme për President të Republikës së Kosovës, të cilat mbahen jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita kur posti i Presidentit ka mbetur vakant.

6. Nëse Kryetari i Kuvendit, për ndonjë nga arsyet e përcaktuara në nenin 90 dhe 91, nuk është në gjendje të shërbejë si Ushtrues i Detyrës së Presidentit, kjo detyrë kalon te Nënkryetari i

Kuvendit. Çështjet e tjera rreth bartjes së përgjegjësisë së ushtrimit të detyrës së Presidentit rregullohen me ligj.

Amendamenti 9

Nenet e mëposhtme të Kushtetutës së Republikës së Kosovës amendamentohen si vijon:

Neni 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare]

1, Kuvendi i Republikës së Kosovës, me votat e dy të tretave (2/3) e të gjithë deputetëve, ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare për këto çështje:

- (1) territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake;
- (2) të drejtat dhe liritë themelore;
- (3) anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare;
- (4) marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga ana e Republikës së Kosovës, **në pajtim me ligjin.**

2. Marrëveshjet ndërkombëtare, me përjashtim të atyre në pikën 1, **konsiderohen të ratifikuara** ~~ratifikohen~~ pas nënshkrimit nga Presidenti i Republikës së Kosovës, **me rekomandim të Qeverisë.**

3. Presidenti i Republikës së Kosovës ose **Kryeministri Qeveria** njoftojnë Kuvendin sa herë që të nënshkruhet një marrëveshje ndërkombëtare.

4. Amendamenti ose tërheqja nga marrëveshjet ndërkombëtare do të kenë të njëjtën procedurë të vendimmarrjes, sikur ajo e ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare.

5. Parimet dhe procedurat për ratifikimin dhe kontestimin e marrëveshjeve ndërkombëtare rregullohen me ligj.

Neni 45 [Të Drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes], paragrafi 1, amendamentohet si vijon:

1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe në ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor, **ose me dispozitat e kësaj Kushtetute.**

Neni 65 [Kompetencat e Kuvendit] Paragrafi 7, amendamentohet si vijon:

7) zgjedh dhe mund të shkarkojë _____ Gjykatën _____ peticionin për
shkarkimin e Presidentit të Republikës së _____ pajtim _____

Neni 80 [Miratimi i Ligjeve]

4. Kuvendi mund të mbivotojë (refuzojë) veton e Presidentit ndaj një ligji të miratuar me shumicën e votave të të gjithë deputetëve plus dhjetë për qind vota të tjera shtesë dhe ai ligj konsiderohet i shpallur. Nëse Presidenti i Republikës ushtron të drejtën e vetos ndaj Ligjit për Buxhet, Kuvendi mund të votojë që të refuzojë (mbivotojë) veton me shumicën absolute të votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit dhe ligji konsiderohet i shpallur. Nëse Kuvendi pranon ndryshimet e propozuara nga Presidenti në ligjin ku ai/ajo ka përdorë veton, Kuvendi vendos për miratimin e atij ligji me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm e që votojnë dhe ligji përkatës konsiderohet i shpallur.

Neni 82 [Shpërndarja e Kuvendit] shfuqizohet paragrafi 1 (3)

~~(3) nëse brenda afatit prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga dita e fillimit të procedurës së zgjedhjes, nuk zgjedhet Presidenti i Republikës së Kosovës.~~

Neni 93 [Kompetencat e Qeverisë]

(10) ~~mund të referojë~~ **ngritë** çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese, **në pajtim me këtë Kushtetutë;**

(12) **i propozon Presidentit themelimin e misioneve diplomatike e konsullore të Republikës së Kosovës;**

(13) **udhëheq politikën e jashtme të vendit;**

Neni 94 [Kompetencat e Kryeministrit]

(5) ~~kryeson~~ **është** anëtar i Këshillit të Sigurisë të Kosovës;

(8) emëron Zëvendësdirjtorin dhe Inspektorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë;

~~(9) këshillohet me Presidentin për zbatimin e udhëheq politikën e jashtme të vendit;~~

Neni 104 [Emërimi dhe Shkarkimi i Gjyqtarëve]

1. Gjyqtarët i emëron, riemëron dhe shkarkon Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. **Presidenti mund të rikthejë kandidatin e propozuar për rishqyrtim në Këshillin Gjyqësor drejtë ushtrorë një për një Gjyqësor propozojë kandidatin e njëjtë vetëm nëse siguron mbështetjen e 2/3 (dy të tretat) të anëtarëve të Këshillit.**

Neni 109 [Prokurori i Shtetit]

7. Kryeprokurori i Shtetit emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, në bazë të propozimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. **Presidenti mund të rikthejë kandidatin e propozuar për rishqyrtim në Këshillin Prokurorial të Kosovës. Këtë të drejtë mund ta ushtrojë vetëm një herë për një kandidat. Këshilli Prokurorial i Kosovës mund të propozojë kandidatin e njëjtë, vetëm nëse siguron mbështetjen e 2/3 (dy të tretave) të anëtarëve të Këshillit.** Mandati i Kryeprokurorit të Shtetit është shtatë (7) vjet, pa mundësi rrimërimi.

Neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

Paragrafi 3 (5) amendamentohet si vijon:

(5) Nëse është shkelur Kushtetuta gjatë zgjedhjes së **Presidentit** dhe Kuvendit.

Paragrafi 6 amendamentohet si vijon:

6. (tridhjetë) a më shumë deputetë të Kuvendi i Kosovës _____ **dorëzojë**
peticionin, _____ identiti _____ së Kosovës në
ka kryer shkelje serioze të Kushtetutës.

Neni 127 [Këshilli i Sigurisë i Kosovës]

2. Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës kryesohet nga **Kryeministri Presidenti i Republikës së Kosovës,** me mbështetje nga Qeveria. ~~përveç gjatë periudhës së Gjendjes së Jashtëzakonshme, sikurse është parashikuar me këtë Kushtetutë.~~

Neni 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese]

2. Gjyqtarët emërohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Kuvendit, për një mandat nëntëvjeçar pa mundësi vazhdimi. Presidenti mund të kthejë kandidatin e propozuar nga Kuvendi. Këtë të drejtë mund ta ushtrojë vetëm një herë për një kandidat. Kuvendi mund të propozojë kandidatin e njëjtë, vetëm nëse siguron mbështetjen e 2/3 (dy të tretave) të votave të të gjithë deputetëve.

Neni 129 [Agjencia e Kosovës për Inteligjencë]

3. Presidenti i Republikës së Kosovës emëron Drejtorin e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë. Zëvendës drejtori dhe Inspektori i Përgjithshëm i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë emërohen nga Kryeministri. Kualifikimi dhe mandati rregullohen me ligj.

Neni 131 [Gjendja e Jashtëzakonshme] amendamentohet si vijon:

8. Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës, vetëm gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, ushtron funksione ekzekutive që kufizohen në funksionet që ndërlidhen në veçanti me Gjendjen e Jashtëzakonshme. ~~Gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës do të drejtohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, sikur rregullohet me ligj.~~ Gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës do të bashkëpunojë ngushtë me Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet ndërkombëtare.

Neni 134 [Kualifikimi, ~~Zgjedhja~~ Emërimi dhe Shkarkimi i Avokatit të Popullit]

1, Avokati i Popullit ~~e zgjedh Kuvendi i Kosovës, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të tij, emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti, me propozim të Kuvendit~~ për një mandat pesë (5) vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje. Presidenti mund të kthejë kandidatin e propozuar nga Kuvendi. Këtë të drejtë mund ta ushtrojë vetëm një herë për një kandidat. Kuvendi mund të propozojë kandidatin e njëjtë, vetëm nëse siguron mbështetjen e 2/3 (dy të tretave) të votave të të gjithë deputetëve.

~~5. Avokati i Popullit mund të shkarkohet vetëm me kërkesën e më shumë se një të tretës (1/3) së të gjithë deputetëve, dhe në këtë rast nga Kuvendi vendos me shumicën e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të tij.~~

Neni 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve]

3. Kryesuesin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve e emëron dhe e shkarkon Presidenti i Republikës së Kosovës nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatave me juridiksion apeli.

Amendamenti 10

[Shpallja e Zgjedhjeve të para Presidenciale], zëvendëson nenin ekzistues 161, si vijon:

Pavarësisht dispozitave të tjera të kësaj Kushtetute:

1. Zgjedhjet e para për Presidentin e Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 86 të Kushtetutës, mbahen pas 6 (gjashtë) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të amendamenteve kushtetuese dhe nga nxjerrja e ligjeve relevante.

2. Mandati i Presidentit të Republikës së Kosovës, i zgjedhur nga Kuvendi, sipas dispozitave të mëhershme të Kushtetutës, vazhdon derisa Presidenti i ri të zgjedhet dhe të bëjë betimin.

3. Presidentët që kanë shërbyer para hyrjes në fuqi të këtyre amendamenteve, kanë të drejtë të zgjedhen dhe rizgjedhen edhe një herë si President i Republikës së Kosovës.

Amendamenti 11

Neni ekzistues 162 [Hyrja në Fuqi], bëhet neni 163 dhe amendamentohet si vijon:

Kushtetuta e Republikës së Kosovës hyn në fuqi më 15 qershor 2008. Amendamentet 1-11 të kësaj Kushtetute hyjnë në fuqi në ditën e miratimit të tyre në Kuvendin e Kosovës. **Pas hyrjes në fuqi të amendamenteve kushtetuese bëhet harmonizimi i ligjeve dhe akteve tjera përgjithshme.**